

20212984674

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

I ZHVILLIMIT, I PRODHIMIT DHE I QARKULLIMIT TË MALLRAVE USHTARAKE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet për kryerjen e zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake, si veprimtari me interes për mbrojtjen dhe sigurinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kushtet dhe procedura për marrjen e pajtimit për kryerjen e zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake, lejeve dhe certifikatave për zbatimin e programit për harmonizim të brendshëm, obligimet e personave të përfshirë në zhvillim, prodhim dhe qarkullim të mallrave ushtarake, kompetencat e organeve të përfshira në procedurat në lidhje me zhvillimin dhe qarkullimin e mallrave ushtarake, si dhe mbrojtjen dhe sigurinë e zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake.

Neni 2

Nocionet e veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë këtë kuptim:

1. “**Mallra ushtarake**” janë mallra, duke përfshirë edhe softuerin dhe teknologjinë, të cilat janë të zhvilluara, prodhuara, të përbëra ose të ndryshuara për qëllime ushtarake, ndërsa janë theksuar në Listën nacionale të kontrollit ushtarak;

2. “**Shenja ML**” domethënë kategori e vetme e mallrave ushtarake të listës nacionale të kontrollit ushtarak në të cilën janë theksuar kategoritë e shënuara me shenjat ML (“ML: Military list code”);

3. “**Personi**” është çdo person vendor fizik dhe juridik, përveç nëse nuk është theksuar se është person fizik ose person juridik;

4. “**Pajtimi**” është akt i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht i Ministrisë së Ekonomisë, i miratuar në procedurë të përcaktuar me këtë ligj, me të cilin lejohet kryerje e zhvillimit dhe prodhimit të mallrave ushtarake, përkatësisht qarkullimit të mallrave ushtarake;

5. “**Zhvillimi**” janë të gjitha fazat para prodhimit serik të mallrave ushtarake, siç janë: projektimi, hulumtimi i projektit, analiza projektuese, zgjidhje ideore, përpunimi, përpilimi, dhe hulumtimi i prototipave, prodhimi provues, të dhënat projektuese, procesi i shndërrimit të të dhënave projektuese në prodhim, projekti për konfigurim ose modifikim, projekti për integrim dhe dokumentacioni teknik;

6. “**Prodhimi**” janë të gjitha fazat e prodhimit të mallrave ushtarake, siç janë: inxhiniering, përpunimi, montimi i prodhimit përfundimtar, remont dhe kontrolli i cilësisë së prodhimit;

7. “**Modifikimi**” është riparimi, përpunimi shtesë i mallrave ekzistuese ushtarake me qëllim të ridedikimit të tyre, ose në mënyrë të rëndësishme, përmirësimi i karakteristikave ekzistuese të mallrave ushtarake, me zëvendësimin dhe ndërtimin e pajisjes plotësuese.

8. “**Remonti**” janë aktivitete të cilat realizohen në mallra ushtarake për shkak të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të karakteristikave të tyre funksionale dhe teknike;

9. “**Qarkullimi**” janë veprime në punën e jashtme tregtare, si: eksport, eksport i përsëritur, import, import i përsëritur, eksport i përkohshëm, import i përkohshëm dhe tranzit të mallrave ushtarake, si dhe sigurimi i shërbimeve të mallrave ushtarake, veprime në punën vendore tregtare, edhe atë blerjen dhe shitjen e mallrave ushtarake në Republikën e Maqedonisë së Veriut; si edhe bartjen elektronike të softuerit dhe të teknologjisë;

10. “**Shërbimi i mallrave ushtarake**” janë: shërbime brokere, ndihmë teknike dhe transport të mallrave ushtarake. Shërbimet e mallrave ushtarake bëhen në bazë të pajtimit për qarkullim të mallrave ushtarake dhe leje adekuate në pajtim me këtë ligj;

11. “**Ofruesit e shërbimeve**” janë personat të cilët japin shërbime në pjesën e shërbimeve brokere, ndihmës teknike dhe transportin e mallrave ushtarake;

12. “**Shërbimet brokerike**” janë: negociata ose kontraktime të transaksioneve për blerje, shitje ose furnizim të mallrave ushtarake nga një vend në vend tjetër, si dhe shitjen ose blerjen e mallrave ushtarake të cilat gjenden në një vend për bartjen e tyre në vend tjetër;

13. “**Brokëri**” është shoqëri tregtare ose tregtar - individ i cili kryen shërbime brokere;

14. “**Shërbimet ndihmëse**” janë shërbimet për: transport, shërbime financiare, sigurim ose risigurim, reklamim dhe promovim. Shërbimet ndihmëse nuk konsiderohen për shërbime brokere;

15. “**Ndihma teknike**” është përkrahje teknike në lidhje me: riparimin, zhvillimin, prodhimin, përpilimin, hulumtimin, atestimin dhe ritestimin, mirëmbajtjen, shkatërrimin ose çfarëdo lloj shërbim tjetër i ofruar për mallra ushtarake, ndërsa i cili mund të jetë edhe në formë të instruksioneve, trajnimit, bartjes së rëndësisë së punës, ose aftësive ose shërbimeve këshillëdhënëse, duke përfshirë dhe ndihmë të siguruar me gojë;

16. “**Ofruesi i ndihmës teknike**” është personi fizik ose juridik vendor ose i huaj, i cili ka marrë pajtim për kryerjen e qarkullimit të mallrave ushtarake dhe ka marrë leje për sigurimin e shërbimeve të mallrave ushtarake dhe i cili siguron ndihmë teknike, pavarësisht nga ajo se ku e ka selinë;

17. “**Transporti**” janë veprimet e kontraktimit të transportit, mundësimin e transportit, ofrimin e shërbimeve ndihmëse për transportuesin dhe transportimin e mallrave ushtarake ndërmjet dy vendeve në pajtim me marrëveshjen për lëvizjen e tyre;

18. “**Transportuesi**” është çdo person i cili siguron shërbime të transportit jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut;

19. “**Zhvendosja**” është zhvendosja e mallrave ushtarake nga njëri person juridik te personi tjetër juridik në kuadër të një vendi/rajoni doganor me ndihmën e çfarëdo lloj mjeti, duke përfshirë edhe bartjen elektronike të softuerit dhe teknologjisë;

20. “**Tranziti**” është zhvendosja ose transporti i mallrave ushtarake nga një vend në vend tjetër me ç’rast mallrat kalojnë nëpër rajonet doganore të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke përfshirë dhe ringarkim;

21. “**Transmetimi elektronik i softuerit dhe i teknologjisë**” është transmetimi i softuerit ose teknologjisë nëpërmjet mediave elektronike, faksit, telefonit, postës elektronike ose mjeteve të tjera elektronike, jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht të territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që përfshin dhe mundëson qasje elektronike deri në softuerin dhe teknologjinë nga ana e personave jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe transmetimi verbal i teknologjisë kur teknologjia është përshkruar nëpërmjet telefonit ose nëpërmjet çfarëdo lloj mjeti për komunikim elektronik;

22. “**Leja**” është dokument të cilin e lëshon Ministria e Ekonomisë në bazë të kërkesës së lëshuar me shkrim në pajtim me dispozitat e këtij ligji, personi i cili ka marrë pajtim për kryerjen e qarkullimit të mallrave ushtarake në pajtim me këtë ligj;

23. “**Leja individuale**” është dokument i cili i jepet eksportuesit, importuesit konkret, persona përgjegjës për tranzit/bartës ose ofrues të shërbimeve për një përdorues përfundimtar ose një pranues dhe përfshin një ose më shumë mallra ushtarake ose shërbime të mallrave ushtarake;

24. “**Leja globale**” është dokument i cili i jepet eksportuesit, importuesit konkret, persona përgjegjës për tranzit/bartës ose ofrues të shërbimeve për çdo lloj ose kategori të mallrave ushtarake dhe e cila mund të vlej për eksport, import ose tranzit ndaj një ose më shumë përdoruesve të theksuar përfundimtar, përkatësisht një ose më shumë vende të shënuara;

25. **“Leja e përgjithshme”** është dokument për eksport, import ose tranzit të mallrave të caktuara ushtarake ose ofrimin e shërbimeve të mallrave ushtarake, për vende konkrete në destinacionin përfundimtar që jepet për të gjithë eksportuesit, importuesit, persona përgjegjës për tranzit/bartës dhe ofrues të shërbimeve të cilët i respektojnë kushtet e saja dhe i përmbushin obligimet e shënuara në lejen e përgjithshme;

26. **“Përdorimi përfundimtar”** është:

- përfshirja e mallrave ushtarake nga Lista nacionale e kontrollit ushtarak;
- përdorimi i pajisjes për prodhim, hetim ose analizë të pjesëve të saja përbërëse për shkak të zhvillimit, prodhimit ose mirëmbajtjes së mallrave ushtarake të theksuara në Listën nacionale të kontrollit ushtarak, dhe
- përdorimi i çfarëdo lloj prodhimi të pambaruar në maqineri për prodhimin e mallrave ushtarake të theksuara në Listën nacionale të kontrollit ushtarak;

27. **“Personi juridik i certifikuar”** është person juridik i cili ka kaluar dhe me sukses ka mbaruar procedurën për certifikim, me qëllim që të vërtetohet besueshmëria e saj në lidhje me mallrat ushtarake, posaçërisht në lidhje me përmbushjen e kushteve ligjore të përcaktuara me këtë ligj dhe kapaciteti t’i përmbush obligimet dhe kufizimet në lidhje me qarkullimin e mallrave ushtarake, si dhe ta zbatojë Programin për harmonizim të brendshëm;

28. **“Programi për harmonizimin e brendshëm”** është dokument për vendosjen e masave efektive, adekuate dhe proporcionale dhe procedurat e dedikuara për personat juridikë;

29. **“Certifikata ndërkombëtare për import”** (“International Import Certificate”) është dokument të cilin e jep organi kompetent shtetëror në vendin e importuesit, me të cilin vërtetohet qëllimi i importuesit, ta importojë mallin ushtarak në vendin e importit, ndërsa pastaj ai mall të mos eksportohet në vende të tjera pa lejen e organit kompetent shtetëror në vendin e importuesit;

30. **“Vërtetimi për dërgesën e bërë”** (“Delivery Verification Certificate”) është dokument të cilin e jep organi kompetent shtetëror në vendin e dërgesës, me të cilën vërtetohet pranuesi, pranimi dhe lloji dhe sasia e mallrave ushtarake, lënda e dërgesës;

31. **“Vërtetimi për përdorues përfundimtar”** (“End-User Certificate”) është dokument i lëshuar nga përdoruesi përfundimtar, me të cilën vërtetohet se malli ushtarak që do të pranohet të përdoruesi përfundimtar është dedikuar për nevoja personale dhe garanton se nuk do të përdoret për qëllime të tjera dhe nuk do të eksportohen te personat e tretë pa pajtim të vendeve eksportuese.

Neni 3

Zhvillimi, prodhimi dhe qarkullimi i mallrave ushtarake i nënshtrohen kontrollit për shkak të mbrojtjes së mbrojtjes dhe të sigurisë, interesave ekonomike dhe interesave të jashtme politike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në drejtim të përforsimit të paqes ndërkombëtare dhe sigurisë, si dhe përmbushjes së obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria) me propozim të Ministrisë së Ekonomisë (në tekstin e mëtejshëm: Ministria), me mendim të marrë paraprak nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Jashtme, e miraton dhe përditëson Listën nacionale të kontrollit ushtarak dhe e boton në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lista nacionale e kontrollit ushtarak e përfshin Listën e përbashkët ushtarake të Bashkimit Europian, si dhe të mallrave ushtarake të cilat i nënshtrohen kontrollit për arsye të lidhura me mbrojtjen dhe sigurinë e shtetit.

Neni 5

Ndalohet zhvillimi, prodhimi dhe qarkullimi i mallrave ushtarake në rast të ekzistimit të bazave për dyshim se mallrat ushtarake mundën plotësisht ose pjesërisht të përdoren për zhvillim, prodhim, shfrytëzim, mirëmbajtje, magazinim, detektim, identifikim ose zgjerim të armëve për shkatërrim masiv, për mjete për dërgim të armëve të tilla për qëllime ushtarake ose terroriste, në destinacionin përfundimtar të cilat janë nën embargo, ose për qëllime me të cilat rrezikohet siguria shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për ekzistimin e bazave për dyshim sipas paragrafit (1) të këtij neni, personat marrin njoftim nga ministria ose organi tjetër kompetent shtetëror.

Eksporti, tranziti ose ofrimi i shërbimeve të mallrave ushtarake për destinacione të cilat janë nën embargo mund të bëhet vetëm nëse masat restriktive adekuate ndërkombëtare lejojnë qarkullim të tillë në rrethana të jashtëzakonshme, me ç'rast Ministria jep leje individuale për transaksion me mendim paraprak nga Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Marrjen e Lejeve për Kryerjen e Qarkullimit të Mallrave Ushtarake (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

Ndalohet kryerja e zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake, përdorim i cili është i ndaluar me konventat ndërkombëtare.

Neni 6

Zhvillimin e mallrave ushtarake kryejnë personat të cilët kanë marrë pajtim nga qeveria për kryerjen e zhvillimit të mallrave ushtarake në pajtim me këtë ligj.

Prodhim të mallrave ushtarake kryejnë personat të cilët kanë marrë pajtim nga qeveria për kryerjen e prodhimit të mallrave ushtarake në pajtim me këtë ligj.

Qarkullim të mallrave ushtarake kryejnë personat të cilët kanë marrë pajtim nga Ministria për kryerjen e qarkullimit të mallrave ushtarake në pajtim me këtë ligj dhe të cilët kanë marrë leje në pajtim me këtë ligj.

Neni 7

Personat e huaj juridikë në bazë të programit të investimit, me pajtim paraprakisht të marrë, mund të investojnë mjete tek personat vendor juridikë të cilët janë të regjistruar për kryerjen e zhvillimit dhe prodhimit të mallrave ushtarake.

Pajtimin sipas paragrafit (1) të këtij neni, Ministria e lëshon në bazë të kërkesës së parashtruar nga personi i huaj juridik, ndërsa me mendime pozitive paraprakisht të marra nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Jashtme.

Formën dhe përmbajtjen e kërkesës për dhënien e pajtimit dhe të dokumentacionit të nevojshëm ndaj kërkesës për kryerjen e zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake i përcakton ministri i Ekonomisë.

Neni 8

Nëse me këtë ligj ndryshe nuk është rregulluar, në procedurat për lëshimin e pajtimeve, lejeve, vërtetimeve dhe certifikatave, zbatohet Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative.

II. ORGANET KOMPETENTE

Ministria e Ekonomisë

Neni 9

Ministria është kompetente për lëshimin e lejeve dhe certifikatave për qarkullimin e mallrave ushtarake.

Ministria është kompetente për ndryshimin, kufizimin, pezullimin, tërheqjen ose revokimin e lejeve të lëshuara.

Neni 10

Ministria grumbullon informacione, të dhëna, dokumentacione dhe dëshmi nga persona dhe institucione, të cilat janë të nevojshme për kryerjen e punëve të parapara me këtë ligj.

Ministria siguron mbrojtjen e besueshmërisë së të gjithë informacioneve, të dhënave, dokumentacioneve dhe dëshmime të marra nga personat e përfshirë në zhvillim, prodhim dhe qarkullim të mallrave ushtarake.

Ministria nuk guxon publikisht t'i botojë dokumentet me të cilat disponon nëse personi i cili i ka parashtruar, ka theksuar se informacionet në dokumentacion janë klasifikuar, përkatësisht fshehtësi afariste.

Dispozitat sipas paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni nuk e pengojnë:

- shfrytëzimin ose shkëmbimin e informacioneve nga ana e Ministrisë ose e Komisionit, për shkak të realizimit të aktiviteteve të tyre të cilat burojnë nga ky ligj dhe aktet e tija nënligjore;
- shfrytëzimin e informacioneve në procedurë paraprake ose gjyqësore, ose për shkak të realizimit dhe veprimit të aktgjyqimit gjyqësor;
- shkëmbimin e informacioneve me organizatat adekuate ndërkombëtare ose qeveritë partnere, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar juridik;
- shkëmbimin ose shfrytëzimin e informacioneve në raste të tjera të parapara me këtë ligj.

Neni 11

Për realizimin e punëve gjatë përcaktimit të përmbushjes së kushteve për lëshimin e lejeve nga ky ligj, Ministria bashkëpunon me organe të tjera të administratës shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe me organe të shteteve tjera.

Neni 12

Ministria kryen informim periodik të të gjithë pjesëmarrësve në procesin e zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake në pajtim me obligimet të cilët dalin nga anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në organizata rajonale dhe ndërkombëtare për stabilitet të sigurisë, për promovimin e transparencës dhe përgjegjësisë më të madhe për transferimin e tyre, me qëllim që të mundësohet harmonizimi me dispozitat e këtij ligji.

Neni 13

Ministria dorëzon për qeverinë raport vjetor për punën e vet në lidhje me kërkesat e parashtruara për lëshimin e lejeve dhe kërkesave të refuzuara, ndërsa në bazë të informacioneve të marra nga Drejtoria e Prodhimit me Dedikim, organi i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë (në tekstin e mëtejshëm: Drejtoria).

Raporti sipas paragrafit (1) të këtij neni, dorëzohet gjatë tremujorit të parë të vitit vijues për vitin paraprak dhe botohet në ueb faqen e ministrisë.

Ministria dorëzon raport për kryerësit e zhvillimit dhe prodhimit të mallrave ushtarake te qeveria në tremujorin e parë të vitit vijues për vitin paraprak.

Drejtoria e Prodhimit me Dedikim në Ministri

Neni 14

Drejtoria është kryerës i punëve profesionale dhe masat në lidhje me zhvillimin, prodhimin dhe qarkullimin e mallrave ushtarake.

Neni 15

Drejtorinë e udhëheq drejtori, të cilin e emëron dhe shkarkon qeveria.

Mandati i drejtorit zgjat katër vjet me mundësi për rizgjedhje.

Për emërimin e drejtorit të drejtorisë shpallet konkurs publik në tre gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, prej të cilave një nga gazetat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase.

Drejtor i Drejtorisë mund të emërohet personi i cili i përmbush këto kushte:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) të ketë të mbaruar arsim të lartë së paku me 240 kredite të fituara sipas SEKT-së ose ka kryer shkallën VII/1;
- 4) të ketë minimum pesë vjet përvojë pune;
- 5) të ketë vërtetim për njohjen e programeve kompjuterike për punën në zyrë;
- 6) të ketë një nga certifikatat e pranuar ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze, jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL (TOEFL IBT) së paku 74 pikë,
 - IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë,
 - ILEC (ILEC) (CambridgeEnglish: Legal) – së paku B2 (B2) nivelin,
 - FCE (FCE) (CambridgeEnglish: Frist) – të dhënë,
 - BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë, ose
 - APTIS (APTIS)- së paku nivelin B2(B2).

Neni 16

Drejtorja i ka këto kompetenca:

- përpunon, miraton dhe zbaton plan dhe program për zbatim efikas të këtij ligji;
- përgatit propozime për përditësimin e Listës nacionale të kontrollit ushtarak;
- mban procedurë për dhënien e mendimeve pozitive ose negative për zhvillim, prodhim, qarkullim të mallrave ushtarake;
- mban procedurë për dhënien e lejeve dhe vërtetimeve në pajtim me këtë ligj;
- zbaton proces për certifikimin e personave juridikë në bashkëpunim me Komisionin për PHB;
- siguron dhe ndërmerr kontrole të përdorimit të fundit/përdoruesit përfundimtar, zbaton mbikëqyrje inspektuese për dërgesë të bërë dhe ka të drejtë të hyjë në hapësirat afariste për qëllimet e tilla;
- jep vërejtje me shkrim për veprime korigjuese;
- mban regjistër për pajtime të dhëna dhe jo të dhëna për kryerjen e zhvillimit të mallrave ushtarake, Regjistër për pajtime të dhëna dhe jo të dhëna për kryerjen e prodhimit të mallrave ushtarake, Regjistër për pajtime të dhëna dhe jo të dhëna për kryerjen e qarkullimit të mallrave ushtarake, Regjistër për leje të dhëna ose jo të dhëna për qarkullimin e mallrave ushtarake, Regjistër për vërtetime të dhëna dhe listë të personave juridikë të certifikuar në pajtim me këtë ligj;
- vendos dhe mban sistem informatik gjithëpërfshirës me bazë të të dhënave për mallra ushtarake dhe për persona të cilët merren me zhvillim, prodhim dhe qarkullim të mallrave ushtarake;
- për shkak të realizimit të kompetencave të veta, formon grupe të punës në lidhje me çështjet konkrete, ku ndihmë dhe përkrahje të vet, japin institucionet adekuate shtetërore, bashkësia akademike, si dhe personat e tjerë;
- vendos dhe mban koordinim, bashkëpunim, ndihmë dhe ndan të dhëna me institucionet adekuate vendore dhe të huaja shtetërore;
- zbaton konferenca informative, seminare dhe punëtori për sektorin industrial, si dhe trajnime për të punësuarit me qëllim ndërtimin e kapaciteteve për zbatim efektiv të këtij ligji;

- i informon personat juridikë për obligimet e tyre të cilat dalin nga ky ligj;
- siguron përkrahje administrative dhe teknike për punën e komisionit;
- u jep ndihmë profesionale personave juridikë në zhvillimin e programeve për harmonizim të brendshëm me sigurimin e informacioneve të nevojshme dhe drejtimeve dhe
- kryen punë tjera të cilët janë të nevojshme për zbatim efektiv të dispozitave të këtij ligji.

Neni 17

Drejtoria zhvillon dhe mban sistem informatik gjithëpërfshirës me bazë të të dhënave për mallra ushtarake dhe për persona të cilët merren me zhvillim, prodhim dhe qarkullim të mallrave ushtarake;

Qasja në informacionet e sistemuara në bazën e të dhënave sipas paragrafit (1) të këtij neni është i kufizuar.

Anëtarët dhe zëvendësanëtarët e komisionit kanë të drejtë në qasjen në informacionet nga baza e të dhënave.

Drejtoria do të lejojë qasje në informacionet të përmbajtura në bazën e të dhënave të organeve të tjera të administratës shtetërore, nëse:

- për atë kanë interes të arsyeshëm,
- kjo nuk është në kundërshtim me Ligjin e Informacioneve të Klasifikuara,
- me këtë nuk shkelet sekreti afarist dhe
- me këtë nuk do të mund të dëmtojë interesat e personit i cili i ka dorëzuar informacionet për të cilat kërkohet qasje.

Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Marrjen e Lejes për Kryerjen e Qarkullimit të Mallrave Ushtarake

Neni 18

Për shqyrtim të kërkesave për marrje të lejeve për kryerje të qarkullimit të mallrave ushtarake, Qeveria formon Komision të Shqyrtimit të Kërkesave për Marrje të Lejes për Kryerje të Qarkullimit të Mallrave Ushtarake.

Komisioni përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, gjashtë anëtarë dhe gjashtë zëvendësanëtarë të përfaqësuesve nga: Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Agjencia e Sigurisë Nacionale dhe Drejtoria e Doganave e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Drejtoria e Doganave).

Në rast të mungesës së ndonjë nga anëtarët e Komisionit, të drejtën e votës e ka zëvendësi i tij.

Komisionin e udhëheq kryetari i Komisionit i cili është përfaqësues i ministrisë.

Anëtari i komisionit, përfaqësues i ministrisë është edhe zëvendëskryetar i komisionit.

Komisioni i kryen këto punë:

- i shqyrton kërkesat për marrje të lejes për kryerje të qarkullimit të mallrave ushtarake dhe jep mendim për kërkesat e dorëzuara;
- jep iniciativë për rregullimin çështjeve për kryerje të qarkullimit të mallrave ushtarake, me këtë ose ligj tjetër;
- realizon bashkëpunim me institucione ndërkombëtare kompetente dhe trupa për çështje nga kompetenca e vet dhe
- e zbaton Listën nacionale të kontrollit ushtarak dhe i respekton masat restriktive në pajtim me Ligjin e Masave Restriktive.

Mendimet e Komisionit jepen me pajtim të të gjithë anëtarëve të Komisionit.

Nëse institucionet që marrin pjesë në punën e komisionit nuk mund të arrijnë pajtim në komision dhe nuk mund të vendosin për kërkesën me konsensus, Komisioni përpilon procesverbal për mendime të ndryshme të anëtarëve të komisionit dhe në afat prej pesë ditësh atë e dorëzon së bashku me kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm për ministrin e Ekonomisë për vendimmarrje.

Komisioni për punën e vet miraton rregullore.

Punët administrative teknike për nevojat e komisionit i kryen drejtoria.

Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Sigurisë Nacionale

Neni 19

Ministria e Punëve të Brendshme i ka këto kompetenca:

- jep mendim dhe merr pjesë gjatë miratimit të akteve nënligjore në pajtim me këtë ligj;
- merr pjesë në punën e komisioneve ndër resore dhe grupeve të punës, të lidhura me zbatimin e akteve nënligjore nga ky ligj;
- kryen punë të tjera në pajtim me këtë ligj.

Ministria e Mbrojtjes i ka këto kompetenca në vijim:

- jep mendim dhe merr pjesë gjatë miratimit të akteve nënligjore në pajtim me këtë ligj;
- zbatojnë kontroll të cilësisë së mallrave ushtarake për nevojat e mbrojtjes dhe sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- kryejnë kontroll ndaj zbatimit të masave për mbrojtje dhe siguri në prodhimin dhe qarkullimin e mallrave ushtarake dhe për mangësitë e konstatuara në afat më të shkurtër me shkrim e njofton ministrinë;
- kryen punë të tjera në pajtim me këtë ligj.

Agjencia e Sigurisë Nacionale kompetencat e veta do t'i zbatojë në pajtim me nenin 8, paragrafi (1), nënparagrafi 7) dhe 10) të Ligjit të Agjencisë së Sigurisë Nacionale.

III. PAJTIM PËR KRYERJE TË ZHVILLIMIT, PRODHIMIT DHE QARKULLIMIT TË MALLRAVE USHTARAKE

Organ kompetent

Neni 20

Pajtim për kryerje të zhvillimit dhe prodhimit të mallrave ushtarake në Republikën e Maqedonisë së Veriut jep qeveria, nën kushte dhe në procedurë të përcaktuara me këtë ligj.

Aktvendim për pajtim për kryerje të qarkullimit të mallrave ushtarake në Republikën e Maqedonisë së Veriut, miraton ministri i Ekonomisë, nën kushte dhe në procedurë të përcaktuara me këtë ligj.

Kushte të përgjithshme për marrje të pajtimit

Neni 21

Me zhvillim dhe prodhim të mallrave ushtarake mund të meren vetëm persona juridikë të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Regjistri Qendror).

Me qarkullim të mallrave ushtarake mund të merren persona të regjistruar në Regjistrin Qendror.

Persona përgjegjës të personave juridikë të regjistruar në Regjistrin Qendror të paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni, janë persona që duhet të kenë vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përveç nëse me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk është përcaktuar ndryshe.

Kushte të posaçme për marrjen e pajtimit

Neni 22

Kryerësit e zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
 - të ketë vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilin e dëshmon me letërnjoftim të vlefshëm;
 - të jetë i shëndetshëm, i aftë të menaxhojë mallrat ushtarake, që dëshmohet me certifikatë mjekësore jo më të vjetër se gjashtë muaj;
 - të kenë të punësuar ose angazhuar persona profesionalë të cilët kanë njohje nga kjo veprimtari (person i cili ka arsim të lartë dhe atë): akademi ushtarake, shkencat teknike, fakulteti i sigurisë ose fakulteti i filozofisë, grupi mbrojtja) dhe do të jenë përgjegjës për sigurimin e dokumenteve dhe akteve, të harmonizuara me këtë ligj dhe rregullat që kanë të bëjnë me veprimtaritë në lidhje me mallrat ushtarake;
 - gjatë paraqitjes së kërkesës për lëshimin e pajtimit, personi nuk është dënuar në mënyrë të plotëfuqishme ose kundër tij nuk udhëhiqet procedurë penale për vepër penale për të cilën ndiqet sipas detyrës zyrtare, përveç për vepër penale të shkaktimit të aksidentit të komunikacionit në komunikacionin rrugor, kurse është kryer nga pakujdesia, që rezulton në lëndime trupore ose dëmtim material;
 - në pesë vitet e fundit para paraqitjes së kërkesës për lëshimin e pajtimit, personave të mos u jetë përcaktuar përgjegjësi për shkeljen e embargos ose sanksionit ndërkombëtar që ishte e detyrueshme për Republikën e Maqedonisë së Veriut;
 - kundër personit dhe personit përgjegjës në personin juridik të mos jetë hapur procedurë kundërvajtëse ose procedurë penale të lidhur me sigurinë shtetërore;
 - kundër personave dhe personit përgjegjës në personin juridik me aktgjykim të plotëfuqishëm të mos jetë shqiptuar dënim ndalesë për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kryerësit e zhvillimit dhe prodhimit të mallrave ushtarake përveç kushteve sipas paragrafit (1) të këtij neni duhet t'i plotësojnë këto kushte:
- të disponojnë me me pajisje përkatëse tekniko-teknologjike dhe mbrojtje të zhvillimit dhe prodhimit të mallrave ushtarake;
 - të disponojnë me hapësira për vendosje dhe ruajtje të mallrave ushtarake;
 - të kenë të vendosur kontroll të cilësisë.
- Kryerësit e zhvillimit të mallrave ushtarake përveç kushteve sipas paragrafit (1) dhe 2 të këtij neni, duhet të posedojnë dhe kapacitete përkatëse zhvillimore, kurse kryerësit e prodhimit, kapacitete përkatëse prodhuese.

Ministri i Ekonomisë për së afërmi i përcakton kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë kapacitetet zhvillimore dhe kapacitetet prodhuese, përkatësisht kryerësit e zhvillimit dhe prodhimit.

Neni 23

Kuadri profesional i cili menaxhon me informacione të klasifikuara te kryerësit e zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit duhet t'i plotësojnë kushtet për menaxhim të informacioneve të klasifikuara në pajtim me Ligjin e Informacioneve të Klasifikuara.

Procedura e marrjes së pajtimit për kryerje të zhvillimit, të prodhimit dhe të qarkullimit të mallrave ushtarake

Neni 24

Për marrje të pajtimit për kryerje të zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit, të personave të interesuar parashtrojnë kërkesë me dokumentacion shoqërues në drejtori.

Drejtoria e mban procedurën me çka mban llogari që dokumentet e bashkangjitura janë të besueshme dhe të plota, kryen kontroll në hapësirat e kërkuarit, përpilon procesverbal për përmbushjen e kushteve, sipas kërkesës së paraqitur dhe të gjitha dokumentet i dorëzon në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme janë të detyruara të dorëzojnë mendime, sipas pranimit të kërkesës nga Drejtoria në afatin e paraparë në Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Pas marrjes së mendimeve nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria:

- përgatit informacion dhe propozimvendim në lidhje me kërkesën e parashtruar për lëshimin e pajtimit për kryerje të zhvillimit ose të prodhimit të mallrave ushtarake, e cila dorëzohet për qeverinë, me qëllim të miratimit të saj nga qeveria dhe

- përgatit informacion dhe dorëzon propozimvendim sipas kërkesës së parashtruar për dhënie të pajtimit për kryerje të qarkullimit të mallrave ushtarake dhe e dorëzon për ministrinë.

Vendimin për marrjen e pajtimit për kryerjen e zhvillimit dhe prodhimit të mallrave ushtarake me kërkesën e parashtruar nga ministria, qeveria duhet ta miratojë në afatin e paraparë me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Nëse ka nevojë për dorëzim të informacioneve shtesë në varësi të ndërlikueshmërisë së lëndës, për të cilat është e nevojshme kontroll shtesë, Ministria ka të drejtë të vazhdojë afatin e procedurës për marrjen e pajtimit, në afatin e paraparë me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative, për të cilën është e detyruar ta njoftojë kërkuar.

Kundër aktvendimit të ministrit të Ekonomisë në lidhje me kërkesën për lëshimin e pajtimit për kryerje të qarkullimit të mallrave ushtarake, kërkuar ka të drejtë të paraqesë ankesë për Komisionin e Vendimarrjes në Procedurë Administrative dhe në Procedurën e Marrëdhënisë së Punës në Shkallë të Dytë nga marrja e aktvendimit, në afatin e paraparë me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Kundër vendimit të qeverisë në lidhje me kërkesën për dhënie të pajtimit për kryerje të zhvillimit ose prodhimit të mallrave ushtarake, kërkuar ka të drejtë të iniciojë kontest administrativ në afatin e paraparë me Ligjin e Kontesteve Administrative.

Ministri i Ekonomisë në pajtim me ministrin e Mbrojtjes dhe ministrin e Punëve të Brendshme i përcaktojnë më afërsisht kushtet në lidhje me hapësirën, pajisjen dhe kuadrin për marrjen e pajtimit për kryerje të zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake, mënyrën e lëshimit të pajtimit për kryerje të zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake, formën dhe përmbajtjen e kërkesës për lëshimin e pajtimit dhe dokumentacionin shoqërues ndaj tyre.

Ndryshimi i regjistrimit në Regjistrin Qendror

Neni 25

Personave të cilëve u është lëshuar pajtimi për kryerjen e zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake për Ministrinë të dorëzojnë ekzemplar nga çdo aktvendim, për ndryshimin e regjistrimit në Regjistrin Qendror, në afat prej tri ditësh pune nga regjistrimi në Regjistrin Qendror.

Heqja e pajtimit

Neni 26

Ministria me aktvendim do ta heq pajtimin për kryerje të qarkullimit, kurse qeveria, me propozim të Ministrisë, me vendim do ta heq pajtimin për kryerje të zhvillimit dhe prodhimit të mallrave ushtarake, në këto raste:

- me kërkesë të bartësit;
- nëse kanë dalë fakte të reja, të cilat nëse kanë ekzistuar në momentin e parashtrimit të kërkesës për lëshimin e pajtimit, do të çonin në miratim të vendimit nga qeveria, përkatësisht aktvendimit nga ministri i Ekonomisë për refuzim;
- nëse tek bartësi përcaktohet përgjegjësi -aktgjykim i plotëfuqishëm për shkelje të dispozitave nga ky ligj, aktet e veta nënligjore ose rregullat e tjera juridike të lidhura me sigurinë shtetërore;
- nëse për bartësin me aktgjykim të plotëfuqishëm përcaktohet përgjegjësi për shkelje të sanksionit ndërkombëtar ose embargo që është e detyrueshme për Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- humbja e aftësisë afariste e personit përgjegjës i cili është regjistruar në Regjistrin Qendror dhe nëse nuk zëvendësohet me person tjetër përgjegjës në afat prej tridhjetë ditësh, përkatësisht plotfuqishmëria e aktvendimit për kufizim/heqje të aftësisë afariste;
- likuidim ose falimentim (shuarje) të personit;
- shkaqe me rëndësi për sigurinë shtetërore ose publike, politikën e jashtme, ose nga interesi i luftës kundër terrorizmit, kontroll të krimit dhe të tjera.
- nëse bartësi kryen punë të cilat nuk janë theksuar në pajtim.

Kundër aktvendimit të ministrit të Ekonomisë për heqjen e pajtimit për kryerje të qarkullimit të mallrave ushtarake, bartësi ka të drejtë të paraqesë ankesë në Komisionin e Vendimmarrjes në Procedurë Administrative dhe në Procedurën e Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në afatin e paraparë me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative, dhe kundër vendimit të qeverisë për marrjen e pajtimit për kryerjen e zhvillimit dhe prodhimit të mallrave ushtarake, bartësi ka të drejtë të iniciojë kontest administrativ në afat të paraparë në pajtim me Ligjin e Kontesteve Administrative.

Ankesa, përkatësisht padia nuk e prolongon realizimin e aktvendimit.

Regjistra të pajtimeve

Neni 27

Drejtoria mban regjistër për pajtimet e dhëna dhe jo të dhëna për kryerjen e zhvillimit të mallrave ushtarake, Regjistër për pajtimet e dhëna dhe jo të dhëna për kryerjen e prodhimit të mallrave ushtarake, Regjistër për pajtimet e dhëna dhe jo të dhëna për qarkullim të mallrave ushtarake, regjistër për lejet e lëshuara dhe të pa lëshuara për tregtinë e mallrave ushtarake, regjistër të vërtetimeve të lëshuara dhe listë të personave juridikë të certifikuar në pajtim me këtë ligj.

Ministri i Ekonomisë e përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave sipas paragrafit (1) të këtij neni.

IV. ZHVILLIMI I MALLRAVE USHTARAKE

Kryerës të zhvillimit të mallrave ushtarake

Neni 28

Zhvillimin e mallrave ushtarake e kryejnë prodhues, qendra shkencore hulumtuese, institucione shkencore hulumtuese dhe kapacitete remontuese.

Neni 29

Kryerësit e zhvillimit të mallrave ushtarake janë të detyruar në bazë të planit vjetor për punë ta ndjekin gjendjen e sigurisë për zhvillimin e mallrave ushtarake në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohen këto çështje.

Neni 30

Kryerësit e zhvillimit të mallrave ushtarake për nevoja të zhvillimit mund të shfrytëzojnë kapacitetet e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe personave të tjerë juridikë të cilëve u është lëshuar pajtimi për kryerje të zhvillimit ose prodhim të mallrave ushtarake (poligonet, vendqitjet, pajisjet etj.), në bazë të marrëveshjeve të ndërsjella.

Kushtet për kryerje të zhvillimit të mallrave ushtarake

Neni 31

Zhvillimi i mallrave ushtarake kryhet për rritjen e kapacitetit luftarak dhe efikasitetin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punëve Brendshme, në pajtim me angazhimet e shprehura në planin afatgjatë të zhvillimit të mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe planet për pajisjen e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe forcat policore me mallra të reja ushtarake.

Kryerësit e zhvillimit të mallrave ushtarake, nëse kryejnë zhvillim personal të produkteve dhe teknologjive të reja, ato mund t'i ofrojnë edhe për blerësit e huaj në bazë të Aktendimit për marrjen e pajtimit për qarkullim dhe leje për eksport të mallrave ushtarake në pajtim me nenin 22 dhe nenin 50 të këtij ligji.

Neni 32

Zhvillimi i mallrave ushtarake për nevojat e Republikës së Maqedonisë së Veriut kryhet në bazë të Programit për zhvillim të mallrave ushtarake që e miraton Qeveria, me propozim të Ministrisë të përpunuar në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Programi për zhvillim të mallrave ushtarake financohet nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe nga burime të tjera për atë dedikim.

Zhvillimi i mallrave ushtarake mund të kryhet dhe në bazë të programeve për zhvillim për nevoja personale të personave juridikë të cilët kanë marrë pajtim për kryerje të zhvillimit ose prodhimit të mallrave ushtarake, të financuara nga mjete financiare personale.

Neni 33

Zhvillimi i mallrave ushtarake për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të personave juridikë të cilët kryejnë prodhim të mallrave ushtarake, kryhen në bazë të marrëveshjeve, të cilat lidhen me kryerësit e zhvillimit të mallrave ushtarake.

Neni 34

Zhvillimi i mallrave ushtarake për nevojat e shteteve të huaja, kryerësit e zhvillimit të mallrave ushtarake i kryejnë në bazë të planeve dhe marrëveshjeve për bashkëpunim.

Zhvillimi i mallrave ushtarake për eksport për shtete të huaja duhet të jetë në pajtim me interesat mbrojtëse, të sigurisë dhe interesat e jashtme politike të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 35

Kryerësit e zhvillimit të mallrave ushtarake janë të detyruar që t'i mbrojnë shpikjet e klasifikuara, përkatësisht inovacionet nga sfera e mbrojtjes së shtetit në pajtim me dispozitat për mbrojtje të patentave.

Dokumentacioni zhvillimor teknik

Neni 36

Dokumentacioni zhvillimor teknik i mallrave ushtarake për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes është pronësi e Ministrisë së Mbrojtjes.

Për përpunimin e dokumentacionit zhvillimor teknik, Ministria e Mbrojtjes dhe kryerësit e zhvillimit të mallrave ushtarake lidhin kontratë me të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Nëse nuk përfundohet zhvillimi i mallrave ushtarake dhe projekti zhvillimor, kryerësit e zhvillimit të mallrave ushtarake janë të detyruar që dokumentacionin origjinal zhvillimor teknik me të cilin disponojnë, ta dorëzojnë për Ministrinë e Mbrojtjes në afat prej tridhjetë ditësh nga ndërprerja e projektit zhvillimor.

V. PRODHIMI I MALLRAVE USHTARAKE

Prodhuesit e mallrave ushtarake

Neni 37

Prodhuesit e mallrave ushtarake janë persona juridikë të cilët kanë marrë pajtim për prodhim të mallrave ushtarake në pajtim me nenet 21 dhe 22 të këtij ligji.

Prodhuesit e mallrave ushtarake janë të detyruar të fillojnë me prodhim më së voni në afat prej një viti, nga dita e dhënies së pajtimit për prodhim të mallrave ushtarake nga qeveria.

Neni 38

Për shkak të kryerjes së detyrave dhe punëve të përcaktuara në procesin e prodhimit të mallrave ushtarake për nevojat e mbrojtjes dhe sigurisë së republikës, tek prodhuesit e mallrave ushtarake mund të dërgohen në punë dhe persona profesionalë të përcaktuar nga ministria.

Të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet Ministrisë dhe prodhuesit të cili janë drejtuar personat profesionalë, rregullohen me marrëveshje.

Neni 39

Prodhuesit e mallrave ushtarake, për nevojat e prodhimit, mund t'i shfrytëzojnë kapacitetet e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe personave të tjerë juridikë të cilët kanë marrë pajtim për kryerje të prodhimit dhe/ose zhvillim të mallrave ushtarake (poligonet, poligonet e gjuajtjes, pajisjet dhe etj), në bazë të marrëveshjeve të ndërsjella në pajtim me ligj.

Neni 40

Prodhuesit e mallrave ushtarake janë të detyruar në bazë të planit vjetor ta ndjekin gjendjen e sigurisë për prodhimin e mallrave ushtarake në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohen këto çështje.

Sigurimi i cilësisë së mallrave ushtarake

Neni 41

Prodhuesit janë të detyruar në prodhimin e mallrave ushtarake të sigurojnë cilësi në pajtim me standardet maqedonase, përkatësisht sipas standardeve përkatëse ndërkombëtare dhe të NATO-së të pranuar nga marrëveshjet ndërkombëtare që janë ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 42

Prodhuesit e mallrave ushtarake janë të detyruar të organizojnë dhe kryejnë kontroll personal të cilësisë, me qëllim të sigurimit të cilësisë së mallrave ushtarake në procesin e prodhimit dhe para rekomandimit.

Neni 43

Kontrolli i cilësisë së mallrave ushtarake sipas dispozitave të këtij ligji kryhet para dhe gjatë importit të mallrave ushtarake.

Kontrolli mund të kryhet dhe gjatë eksportit të mallrave ushtarake sipas kërkesës së prodhuesit, nëse nuk është rregulluar me marrëveshje për shitëblerje.

Neni 44

Kontrollin e cilësisë së mallrave ushtarake për nevojat e mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut e kryen Ministria e Mbrojtjes, kurse për nevojat e sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut e kryen dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Pas kontrollit të kryer të cilësisë në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, Ministria e Mbrojtjes, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme, lëshojnë vërtetime për cilësi të mallrave ushtarake nëse ka të bëjë me nevojat e tyre.

Dokumentacioni teknik për prodhim

Neni 45

Prodhuesi i mallrave ushtarake është i detyruar për mallrat ushtarake të sigurojë dokumentacion teknik.

Ministri i Mbrojtjes në pajtim me ministrin e Punëve të Brendshme, e përcakton formën dhe përmbajtjen e dokumentacionit teknik.

Neni 46

Mallrat ushtarake nuk mund të lëshohen në qarkullim nëse për to prodhuesi nuk ka siguruar dokumentacion teknik në pajtim me këtë ligj.

Kushte për kryerje të prodhimit

Neni 47

Prodhimi i mallrave ushtarake kryhet në pajtim me Listën nacionale të kontrollit ushtarak.

Neni 48

Për objektet në të cilat kryhet prodhimi i mallrave ushtarake me karakter eksploziv, duhet të ketë aktvendim për lokacionin nga Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve pas marrjes së pajtimit paraprakisht nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Neni 49

Prodhuesit vendor të mallrave ushtarake, të cilët prodhojnë mallra ushtarake në bashkëpunim me prodhuesit e huaj, kanë të drejtë t'i importojnë pjesët nga prodhimet ose prodhimet komplet nga bashkëpunëtorë të huaj.

VI. QARKULLIM I MALLRAVE USHTARAKE

Kushte për kryerje të qarkullimit të mallrave ushtarake

Neni 50

Kryerësit e qarkullimit të mallrave ushtarake janë persona juridikë të cilët kanë marrë aktvendim për kryerje të qarkullimit të mallrave ushtarake në pajtim me nenet 21 dhe 22 të këtij ligji.

Kryerësit e qarkullimit të mallrave ushtarake këtë e kryejnë në bazë të Listës nacionale të kontrollit ushtarak.

Gjatë kryerjes së eksportit, eksportit të përsëritur, importit, importit të përsëritur, eksportit të përkohshëm dhe importit të përkohshëm dhe tranzitit të mallrave ushtarake, do të zbatohen dispozitat e Ligjit të Doganave të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Leja për kryerjen e qarkullimit të mallrave ushtarake

Neni 51

Me qëllim të kryerjes së qarkullimit të mallrave ushtarake kryerësit e qarkullimit janë të detyruar të sigurojnë leje përkatëse për kryerje të qarkullimit të mallrave ushtarake (në tekstin e mëtejshëm: leje) në pajtim me këtë ligj.

Lejet sipas paragrafit (1) të këtij neni i lëshon ministria në bazë të mendimit të komisionit.

Ministria i lëshon këto lloje të lejeve:

- leje individuale,
- leje globale dhe
- leje e përgjithshme.

Lejet sipas paragrafit (3) të këtij ligji lëshohen për persona të cilët kanë marrë aktvendim për kryerje të qarkullimit të mallrave ushtarake.

Leja individuale lëshohet për eksport, eksport të përsëritur, import, import të përsëritur, eksport të përkohshëm dhe import të përkohshëm dhe tranzit të mallrave ushtarake, ose për sigurimin e shërbimeve të mallrave ushtarake, si dhe bartje elektronike të softuerit ose teknologjisë dhe leje individuale për import ose eksport të përkohshëm nga Republika e Maqedonisë së Veriut për mallra ushtarake vetëm për testim ose prezantim.

Leja individuale sipas paragrafit (5) të këtij neni, lëshohet për kryerje të shërbimeve të mallrave ushtarake në këto raste:

- broker i cili i siguron shërbimet e veta brokere në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- broker me vendbanim, përkatësisht seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili i siguron shërbimet e veta brokere jashtë vendit;
- ofrues i ndihmës teknike i cili ia siguron shërbimin e tij klientit jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- ofrues i ndihmës teknike me vendbanim, përkatësisht seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili e siguron shërbimin e tij jashtë vendit dhe
- transportues me vendbanim, përkatësisht seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili e siguron shërbimin e tij jashtë vendit.

Leja individuale për eksport dhe import është e nevojshme edhe në rast të bartjes elektronike të softuerit ose teknologjisë nëpërmjet mediave elektronike, faksit, telefonit, postës elektronike ose mjeteve të tjera elektronike jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila përfshin sigurimin e qasjes elektronike në softuer dhe teknologji nga persona jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe transferimin verbal të teknologjisë kur teknologjia përshkruhet nëpërmjet telefonit ose nëpërmjet çfarëdo mjeti tjetër të komunikimit elektronik.

Leje globale lëshohet për persona juridikë që kanë vendosur program për harmonizim të brendshëm.

Leja e përgjithshme lëshohet për eksport, import ose tranzit të mallrave ushtarake, pse për sigurim të shërbimeve, nën kushtet dhe në vende të caktuara të cilat janë theksuar në nenet 57 dhe 58 të këtij ligji. Ministria patjetër duhet ta publikojë lejen e përgjithshme në ueb faqen e ministrisë. Leja e përgjithshme lëshohet për persona të cilët janë regjistruar si shfrytëzues të lejes së përgjithshme në pajtim me kushtet e parapara në këtë ligj dhe aktet përkatëse nënligjore. Leja e përgjithshme nuk mund të përdoret nëse ministria ose organ tjetër shtetëror kompetent ka informuar eksportuesin, importuesin, personin përgjegjës për tranzitin/bartësin ose ofruesin e shërbimit që mallrat ose shërbimet në fjalë mund të jenë ose jo të destinuar pjesërisht ose në tërësi për:

- armët e shkatërrimit në masë ose mjetet e dërgimit të armëve të tilla dhe
- përdorim përfundimtar në një destinacion i cili është nën embargo.

Leja e përgjithshme gjithashtu nuk duhet të përdoret nëse eksportuesi, importuesi, personi përgjegjës për tranzitin ose ofruesi i shërbimit kanë arsye të dyshojnë se produktet ose shërbimet janë të destinuar për qëllimet e theksuara në pikën paraprake.

Neni 52

Leja nuk mund të bartet te personi tjetër dhe me të miratohet vetëm një transaksion konkret ose pjesë nga transaksionet në pajtim me atë të theksuar në leje.

Procedura për lëshimin e lejeve

Neni 53

Për lëshim të lejes parashtrohet kërkesë me dokumentacion shoqëruar në drejtori.

Me kërkesën duhet të dorëzohet përshkrim i qartë i mallrave ushtarake dhe të bashkëngjiten të gjitha provat e nevojshme për vërtetimin e të dhënave të theksuara në kërkesë, si karakteristikat teknike, skica, fotografitë dhe dokumentet e tjera për identifikimin e mallrave ushtarake.

Në bashkëngjitje të kërkesës, brokeri duhet të dorëzojë kontratë të shitjes, vërtetime të porosisë, faturat ose dërgesat (nëse janë të kapshme) dhe “vërtetim për përdoruesin përfundimtar” në formë origjinale ose kopje të vërtetuar në noter dhe përkthim nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor të verifikuar në noter.

Brokeri duhet të dorëzojë edhe të dhëna për lokacionin e prejardhjes së mallrave ushtarake.

Kërkuesi ndaj kërkesës gjithashtu duhet t'i bashkëngjitë deklaratë me shkrim se menjëherë do ta njoftojë Ministrinë nëse merr njohuri të informacioneve se mallrat do të jenë tërësisht ose pjesërisht të destinuar për zhvillimin, prodhimin, përdorimin, mirëmbajtjen, ruajtjen, zbulimin, identifikimin ose shpërndarjen e armëve për shkatërrim në masë, mjete për shpërndarjen e tij për qëllime ushtarake në destinacione të embargos ose për rrezikimin e sigurisë nacionale.

Ministri i Ekonomisë e përcakton mënyrën e lëshimit të lejeve, formën dhe përmbajtjen e kërkesave për lëshimin e lejeve, dokumentacionin e nevojshëm, si dhe formën dhe përmbajtjen e lejeve të nenit 51 paragrafi (2) të këtij ligji.

Neni 54

Pas pranimit të kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues të nenit 53 të këtij ligji, drejtoria kontrollon nëse e ajo është e plotë dhe e qartë. Në rast të kërkesës jo të plotë ose të paqartë, përkatësisht dokumentacion të paplotë në pajtim me formularin e përshtuar, drejtoria në afatin e paraparë me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative, e njofton kërkuesin ta rregullojë kërkesën dhe e dorëzon dokumentacionin shtesë.

Afati për përpunimin e kërkesës dhe dorëzimin e dokumentacionit shtesë pushon të rrjedh nga data kur drejtoria do ta njoftojë kërkuesin për ndërprerje të procedurës ta rregullojë kërkesën, kurse procedura vazhdon nga data e marrjes në drejtori të kërkesës së rregullt.

Nëse kërkuesi nuk e rregullon kërkesën dhe nuk e dorëzon dokumentacionin shtesë në afatin e theksuar, kërkesa me aktvendimin hidhet poshtë në afatin e paraparë me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Neni 55

Kërkesën e rregulluar dhe dokumentacionin e nevojshëm drejtoria e dorëzon në komision për shkak të marrjes së mendimit.

Komisioni përgatit mendim sipas kërkesës në afatin e paraparë me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative nga dita e parashtrimit të rregullt të kërkesës.

Komisioni sipas nevojës mund të kërkojë kontrolle plotësuese të informacioneve dhe dokumentet e bashkëngjitura me kërkesën.

Ministria e Ekonomisë do të miratojë aktvendim për miratim ose refuzim të kërkesës për lëshimin e lejes së kërkuar, nga pranimi i mendimit të Komisionit në afatin e paraparë me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Nëse Komisioni jep mendim negativ ministri i Ekonomisë do të miratojë aktvendim për marrje të kërkesës për lëshimin e lejes.

Drejtoria dorëzon për kërkuesin aktvendim, në afat prej tre ditë pune nga dita e miratimit të aktvendimit.

Kërkesa për leje mund të jetë e miratuar plotësisht, pjesërisht ose të jetë e kufizuar me kushte ose kufizime të tjera të cilat janë theksuar në leje.

Kufizimi mund të zbatohet për ndalimin eksportit të përsëritur pa miratimin e vendit eksportues.

Në aktvendimin për refuzim të kërkesës do të theksohet arsyetimi i shkaqeve për refuzim, përkatësisht për mendim negativ të Komisionit, vetëm nëse të ato bazohen ndaj informacioneve të cilat kanë shkallë përkatëse të besueshmërisë në pajtim me ligjin, ose në bazë të kritereve të përcaktuara me Ligjin e Informacioneve të Klasifikuara, ose informacione të cilat janë të mbrojtura në pajtim me dispozitat për mbrojtje të të dhënave personale.

Neni 56

Leja lëshohet në formë të shkruar në pesë ekzemplarë, nga të cilat:

- katër ekzemplarë drejtoria i dorëzon për kërkuesin, nga të cilët një mban për vete kurse nga një ekzemplar dorëzon për Drejtorinë e Doganave, e cila përdoret gjatë procedurës së eksportit, eksportit të përsëritur, importit, importit të përsëritur, eksportit të përkohshëm dhe importit të përkohshëm, tranzitit dhe për Ministrinë e Punëve të Brendshme - Policia e Kufitare, kurse ekzemplari i katërt është për nevojat e drejtorisë dhe

- një ekzemplar ruhet në arkivin e drejtorisë.

Leja mund të lëshohet edhe në formë elektronike.

Në leje është theksuar numri i lejes, data e miratimit, afati i skadimit të vlefshmërisë dhe të dhëna tjera të rëndësishme. Shtojcat ndaj lejes sipas nevojës gjithashtu të verifikohen sipas dispozitave për punë zyrtare dhe arkivore.

Pronari i lejes patjetër ta shfrytëzojë numrin e ndarë të lejes në komunikim me ministrinë në lidhje me çfarëdo çështje të lidhura me transaksionet e përfshira me lejen.

Leja sipas paragrafit (1) të këtij neni, i dorëzohet kërkuarit personalisht, nëpërmjet postës së propozuar ose sipas formës elektronike.

Pas përfundimit të procedurës për eksport ose tranzit, ministria mund të kërkojë nga bartësi i lejes të bashkëngjit vërtetim për rekomandim të kryer të lëshuar nga organet kompetente të vendit të destinacionit.

Kriteret për shqyrtimin dhe refuzimin e kërkesës

Neni 57

Gjatë vendimmarrjes nëse do të miratohet, gjegjësisht refuzohet kërkesa për lëshimin e lejes në pajtim me ligjin, ministri i Ekonomisë dhe komisioni i marrin parasysh të gjitha rrethanat relevante, mes tjerash;

1. Respektimin e obligimeve ndërkombëtare dhe angazhimet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në veçanti lidhur me sanksionet e miratuara nga ana e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose Bashkimit Europian, marrëveshjen për mos zgjerimin e armëve për shkatërrim të armëve në masë dhe problematika tjera, si dhe obligimet e tjera ndërkombëtare;

2. Respektimin e të drejtave ndërkombëtare në vend në përcaktimin përfundimtar, si dhe respektimin e të drejtës humanitare nga ai vend, në veçanti në pikëpamjen e rreziqeve se malli ushtarak mund të përdoret për kryerjen ose mundësimin e veprave serioze të dhunës gjinore, ose veprave serioze të dhunës kundër grave dhe fëmijëve;

3. Gjendjen e brendshme në vend në përcaktimin përfundimtar, si dhe ngritjen e tensioneve ose konflikteve të armatosura;

4. Ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon;

5. Sigurinë shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe sigurinë e vendeve miqësore ose aleate;

6. Sjelljen e vendit blerës në raport me komunitetin ndërkombëtar, në veçanti marrëdhënia e tij ndaj terrorizmit, natyrës së aleatëve të tij dhe respektimi i të drejtës ndërkombëtare;

7. Ekzistimin e rrezikut se teknologjia ose pajisjet ushtarake mund të drejtohen në suaza të vendit blerës ose të eksportohet nën kushte të padëshirueshme;

8. Përkatësinë në teknologjinë ose pajisjet ushtarake që eksportohen me kapacitet tekniko-ekonomik të vendit pranues, në ç'rast duke pasur parasysh synimin e shteteve që i plotësojnë nevojat e veta nga interesi i sigurisë dhe i mbrojtjes, me të cilën që sa më pak të angazhohen burimet njerëzore dhe ekonomike për armatim.

9. Rezikimin e politikave të jashtme ose interesave ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ose në kundërshtim me këto interesa;

10. Kërkuar që ka dorëzuar dokumente të rrejshme, ka dhënë të dhëna të cilat të çojnë në konkluzion të gabuar, ose kanë fshehur materiale në kërkesë ose në materialet shoqëruese;

11. Në pesë vitet e ardhshme kërkuar a e ka shkel këtë ligj, aktet e tija nënligjore ose rregullat e tjera juridike lidhur me sigurinë e shtetit;

12. Në pesë vitet e fundit nëse kërkuar e ka shkel të drejtën ndërkombëtare të embargos ose sanksionit i cili ka qenë i detyrueshëm për Republikën e Maqedonisë së Veriut;

13. Nëse kundër kërkuarit është ngritur procedurë penale ose kundërvajtëse lidhur me sigurinë shtetërore nga informacionet e marra nga ana e organit kompetent;

14. Malli për të cilin kërkohet leje është lëndë e hetimit policor ose procedurës gjyqësore.

Periudha e vlefshmërisë së lejes

Neni 58

Leja individuale vlen për periudhën deri në një vit, me përjashtim të lejes individuale për tranzit dhe leje ndërkombëtare për import dhe eksport të përkohshëm, që vlejné për periudhën deri në gjashtë muaj.

Leja globale është me vlefshmëri deri në pesë vjet.

Ministri e përcakton afatin e vlefshmërisë së çdo leje të lëshuar, në ç'rast duke pasur parasysh kohëzgjatjen e marrëveshjes në bazë të së cilës është dhënë leja që dalin nga lloji tjetër i mallrave ushtarake.

Llogaritet se leja nuk vlen nga momenti kur do të përfundojnë formalitetet doganore për të gjitha mallrat e cekura në leje.

Leja e përgjithshme lëshohet në kohë të papërcaktuar dhe ajo nuk vlen derisa të hiqet ose anulohet.

Vazhdimi i afatit të vlefshmërisë së lejes

Neni 59

Për vazhdimin e afatit të lejes, pronari i lejes është i obliguar në Ministri t'i kthejë ekzemplarët origjinal të lejes dhe ta dorëzojë kërkesën e re, në pajtim me nenin 53 të këtij ligji, në afat prej pesëmbëdhjetë ditë pune para datës së skadimit të vlefshmërisë së lejes.

Ministri i Ekonomisë miraton aktvendim sipas kërkesës sipas paragrafit (1) të këtij neni, në bazë të vlerësimit të shkaqeve në të cilat ajo bazohet dhe hulumtohet nëse ende plotësohen kushtet për lëshimin e lejes në pajtim me nenin 53, paragrafi 1 të këtij ligji.

Ministri lëshon leje në pajtim me afatet e vlefshmërisë së nenit 58 të këtij ligji.

Anulimi, heqja, përkufizimi dhe ndryshimi i lejes

Neni 60

Ministria e anulon lejen nëse ajo ka qenë e lëshuar në bazë të të dhënave jo të sakta dhe jo të plota, ose ka pasur mbulim të fakteve materiale.

Në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, leja është e anuluar dhe çdo veprim që merret në bazë të lejes së tillë është i pavlefshëm.

Neni 61

Ministria mund t'ia marrë lejen nëse:

- pronari i lejes kërkon ndërprerjen e saj;
- konfirmon se është shkaktuar ndryshim i dukshëm tek të dhënat e lejes të cilat nuk përshtaten me të dhënat e kërkesës;
- pronari i lejes nuk i plotëson obligimet ose kushtet nga leja që janë të shënuara në dokumentacionin teknik, specifikacionin për furnizimin e pajisjeve ose marrëveshjen për shitblerje;
- te pronari i lejes është konstatuar përgjegjësi për shkeljen e këtij ligji, me interes të sigurisë nacionale;
- pronari i lejes nuk vepron sipas kërkesës së ministrisë për dorëzimin e informacioneve lidhur me dokumentet e dorëzuara për vërtetimin e dërgesës së mallrave në faza, në bazë të cilës është lëshuar leja;
- personi i cili është pronar i lejes i ndërpritet ekzistimi;
- do të konfirmojë një ose më shumë kushte në bazë të cilës është lëshur leja tashmë nuk është plotësuar, përkatësisht nuk janë plotësuar;

- eksportuesi, përkatësisht ofruesi i shërbimeve nuk e ka informuar ministrinë për ndryshimet lidhur me lejen e lëshuar;
- eksportuesi e bart lejen për eksport eksportuesit tjetër;
- fillojnë të vlejné masat restriktive në pajtim me Ligjin e Masave Ndërkombëtare Restriktive.

Neni 62

Nëse dalin fakte të reja për lëvizjen e mallrave ushtarake siç janë: ndryshimi i përcaktimit përfundimtar, ndryshimi i marshutës ose ndryshimi i përdoruesit përfundimtar, që nuk kanë qenë të njohur në momentin e shqyrtimit të kërkesës dhe miratimit të lejes, Ministria mund ta ndryshojë lejen në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve nga miratimi i kërkesës për ndryshim.

Neni 63

Ministria mund ta ndryshojë lejen me çka do të lëshojë leje të re në pajtim me nenin 62 të këtij ligji.

Neni 64

Drejtoria në formë të shkruar e informon Drejtorinë e Doganave dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme për lëshimin, anulimin ose marrjen e lejes.

Neni 65

Drejtoria në formë të shkruar e informon pronarin e lejes për lëshimin, anulimin ose heqjen e lejes.

Heqja e lejes përkohësisht

Neni 66

Ministria mundet përkohësisht ta marrë lejen nëse pronari i lejes nuk i mënjanon parregullsitë e konstatuara në procedurën për mbikëqyrje në pajtim me nenin 106 të këtij ligji. Për shkak të mos mënjanimit të parregullsive mundet përkohësisht të merret leja derisa pronari i lejes nuk dëshmon se i ka plotësuar kushtet sipas dispozitave të këtij ligji.

Marrja e lejes përkohësisht, mund të jetë në kohëzgjatje së paku prej 30 ditësh, dhe në rast të ekzistimit të dyshimit se qarkullimi i mallrave nuk ka qenë ose do të kryhet në kundërshtim me kushtet ekzistuese të lejes.

Ministri i Ekonomisë mundet me aktvendim ta ndërpret dërgesën e mallrave ushtarake ose ofrimin e shërbimeve, në kohëzgjatje prej 15 ditësh, në cilëndo fazë të procesit që të mund të kontrollojë ligjshmërinë e tyre.

Në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, nëse dërgesa tashmë është transportuar, ministri i ekonomisë ka autorizim që të miratojë aktvendim për kthimin ose shkarkimin e një dërgese të tillë në cilindo stacion të rrugës, në afat prej 15 ditësh, në çka për këtë do ta informojë Drejtorinë e Doganave.

Ministri ka të drejtë përkohësisht t'ua marrë lejet për vendet në të cilat ka keqësim të madh të sigurisë dhe stabilitetit, si përgjigje të krizës ose lejes për dërgesë ose ofrim të shërbimeve për përdoruesin konkret përfundimtar, në ç'rast marrja e lejes mund të zgjatë më shumë deri në përfundimin e krizës.

Pronari i lejes në formë të shkruar informohet për marrjen e lejes përkohësisht dhe sa është kohëzgjatja e marrjes së lejes. Nëse para skadimit të periudhës fillestare kohore ende ekziston baza për dyshim, periudha e marrjes së përkohshme vazhdohet edhe një muaj. Pronari i lejes e informon për vazhdimin e periudhës në formë të shkruar.

Kthimi i lejes

Neni 67

Pronari i lejes është i obliguar ta kthejë lejen në Ministri në afat prej tre ditë pune nga dita e informimit zyrtar për marrjen e përhershme, anulimin ose marrjen e përkohshme të lejes, përpos kur leja nuk është lëshuar në formë elektronike, anuluar ose humbur. Nëse leja është gjetur pastaj, kjo kthehet pa prolongim.

Në rast kur pronari i lejes vendos të mos e përdor lejen është i obliguar ta kthejë në Ministri, për të cilin i jepet vërtetim me shkrim.

Përfundime lidhur me lëshimin e lejes

Neni 68

Lejen e lëshon Ministria e Ekonomisë, përpos në këto raste:

- leje për import ose donacione të mallrave ushtarake për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, e lëshon Ministria përkatëse, në pajtim me vendimin e miratuar nga Qeveria,

- leje për eksport të përkohshëm të mallrave ushtarake për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme ose për institucione tjera përkatëse të sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e lëshon ministria përkatëse, përkatësisht institucioni shtetëror, në pajtim me vendimin e miratuar nga qeveria,

- leje për eksport dhe import të mallrave ushtarake në bazë të marrëveshjeve të lidhura dhe donacioneve nga ana e qeverisë e lëshon Ministria e Mbrojtjes përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme,

- lejen për eksport dhe tranzit të mallrave ushtarake për misione paqësore ndërkombëtare ose misione humanitare e lëshon Ministria e Mbrojtjes përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme dhe

- lejen për shfrytëzimin e shërbimeve të mallrave ushtarake për nevojat e Ministrisë së Punëve të Brendshme përkatësisht Ministrisë së Mbrojtjes, e lëshon ministria për nevojat e së cilës kryhen shërbimet.

Përdorimi i lejes

Neni 69

Eksporti i mallrave ushtarake bëhet me shfaqjen e lejes, ndërsa në deklaratën doganore shënohet udhëzimi për përdorimin e lejes në fjalë, duke përfshirë edhe në raste kur përdoret leja e përgjithshme.

Importi i mallrave ushtarake bëhet me shfaqjen e lejes, ndërsa në deklaratën doganore shënohet udhëzimi për përdorimin e lejes në fjalë.

Tranziti i mallrave ushtarake bëhet me shfaqjen e lejes, ndërsa në deklaratën doganore shënohet udhëzimi për përdorimin e lejes në fjalë.

Ofruesi i shërbimeve është i obliguar të dorëzojë leje në Drejtorinë e Doganave me kërkesë të tyre paraprake.

Personi i cili kryen transemitim elektronik të softuerit ose teknologjisë është i obliguar të dorëzojë leje në Drejtorinë e Doganave.

Procedura doganore, doganimi dhe mbikëqyrja doganore e mallrave ushtarake të cilat eksportohen ose importohen bëhet nëpërmjet prodhuesit, importuesit ose Ministrisë së Mbrojtjes, përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme, në pajtim me dispozitat e Ligjit të Doganave.

Mbikëqyrja doganore bëhet në prani të përfaqësuesit të Ministrisë së Mbrojtjes, përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Obligimi për shënim të përshkrimit të dokumenteve

Neni 70

Në dokumentet komerciale lidhur me qarkullimin e mallrave ushtarake duhet qartë të theksohet se bëhet fjalë për mallra ushtarake dhe se ato u nënshtrohet kontrolleve.

Dokumentet komerciale përfshijnë marrëveshje për shitje, vërtetim të porosisë, faturë ose fletëdërgesë.

Ankesa në procedurë administrative

Neni 71

Kundër aktvendimeve lidhur me lejet e miratuara në pajtim me nenet 55, 59, 60, 61, 62, 63 dhe 66 të këtij ligji, lejohet ankesë në Komisionin e Vendimarrjes në Procedurë Administrative dhe në Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë nga dita e pranimit të aktvendimit, në afatin në e paraparë në Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Ankesa sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk e prolongon realizimin e aktvendimit.

Regjistri i lejeve

Neni 72

Drejtoria mban regjistër të lejeve në të cilin i evidenton të gjitha kërkesat e refuzuara për marrjen e lejes, si dhe të gjitha ndryshimet të lejet e lëshuara.

Ministri i Ekonomisë e përcakton formën përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së regjistrit sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Vërtetimi për përdoruesin përfundimtar dhe certifikata ndërkombëtare për import

Neni 73

Ministria lëshon leje për përdoruesin përfundimtar (End-User Certificate) dhe certifikatë ndërkombëtare për import (International Import Certificate) në bazë të kërkesës nga importuesi dhe deklarata me shkrim nga përdoruesi përfundimtar për qëllimin e mallrave të importuara ushtarake.

Në vërtetimin e përdoruesit përfundimtar përmendet se nuk do të kryhet eksport përsëri ose zhvendosje e përsëritshme e mallit ushtarak pa leje përkatëse nga Ministria.

Nëse malli ushtarak importohet për nevojat e mbrojtjes ose policisë, vërtetimin për përdoruesin përfundimtar e lëshon Ministria e Mbrojtjes, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme.

Vërtetimet për përdorim përfundimtar për mallrave ushtarake, të lëshuar nga Ministria me dedikim për import në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duhet të vihen në kontroll tek organet kompetente të vendit për eksport në afat prej gjashtë muajve nga dita e lëshimit.

Ministri i Ekonomisë e përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesës për lëshimin e vërtetimit për përdorues përfundimtar, formën dhe përmbajtjen e formularit të vërtetimit të përdoruesit përfundimtar dhe certifikatë ndërkombëtare për import.

Vërtetim për përdorim përfundimtar

Neni 74

Ministria lëshon vërtetim për përdorim përfundimtar (End-Use Certificate) në bazë të kërkesës nga importuesi dhe dedikimi i mallrave ushtarake të cilat importohen.

Drejtoria mund të kërkojë edhe dokumente plotësuese për shkak të plotësimit të kushteve të vendit eksportues për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurisë shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ministria mundet me kërkesë të vendit – dërgues të lëshojë vërtetim për përdorim përfundimtar të mallrave ushtarake të cilat nuk janë përfshirë me Listën nacionale të kontrollit ushtarak.

Ministri i Ekonomisë e përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesës për lëshimin e vërtetimit për përdorues përfundimtar, formën dhe përmbajtjen e formularit të vërtetimit për përdorim përfundimtar.

Vërtetimi për dërgesën e kryer

Neni 75

Ministri i Ekonomisë e përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesës për lëshimin e vërtetimit për dërgesën e realizuar dhe formën dhe përmbajtjen e vërtetimit për dërgesën e përfunduar.

Bazat e refuzimit të kërkesës për lëshimin e vërtetimit për përdorues përfundimtar, vërtetim për përdorim përfundimtar dhe certifikatë ndërkombëtare për import

Neni 76

Ministri mund të refuzojë lëshimin e vërtetimit për përdoruesin përfundimtar, vërtetim për përdorim ushtarak përfundimtar dhe certifikatë për import, për shkak të këtyre shkaqeve:

- kërkuesi nuk ka marrë pajtim për kryerjen e zhvillimit, prodhimit ose qarkullimit të mallrave ushtarake;

- kërkuesi ka dorëzuar dokumente të rrejshme, ka shënuar të dhëna të cilat sjellin në konkluzion të gabuar ose ka fshehur fakte materiale në kërkesë ose në dokumentet shoqëruese;

- në pesë vitet e fundit kërkuesi e ka shkelë këtë ligj, aktet e tija nënligjore ose rregulla të tjera juridike lidhur me sigurinë e shtetit;

- në pesë vitet e fundit kërkuesi ka shkelur embargon ndërkombëtare ose sanksione të cilat kanë qenë të obligueshme për Republikën e Maqedonisë së Veriut;

- nëse kundër kërkuetit është ngritur procedurë penale ose kundërvajtëse lidhur me sigurinë shtetërore nga informacionet e marra nga ana e organit kompetent për ekzistimin e besueshmërisë së ligjit se malli ushtarak ndoshta nuk do të përdoret për përdorimin e parashtruar përfundimtar ose do të eksportohet përsëri ose do të bartet përsëri nën rrethana të padëshiruara në kuptimin e nenit 57 të këtij ligji.

Heqja e vërtetimit për përdorues përfundimtar, vërtetimit për përdorim përfundimtar dhe certifikatës ndërkombëtare për import

Neni 77

Vërtetim për përdorim përfundimtar, vërtetim për përdorues përfundimtar dhe certifikatë ndërkombëtare për import të lëshur nga ministria, mund të hiqet vetëm nëse mallrat ushtarake të përfshira me ato nuk importohen në Republikën e Maqedonisë.

Ministria është e obliguar që ta informojë organin kompetent të vendit eksportues në rast të:

- heqjes së vërtetimit për përdorues përfundimtar, vërtetim për përdorim përfundimtar dhe certifikatë ndërkombëtare për import ose

- shkaktimit të ndryshimeve të dukshme lidhur me përdorimin përfundimtar të mallrave ushtarake të importuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kthimi i vërtetimit për përdorim përfundimtar, vërtetimit për përdorues përfundimtar dhe certifikatës ndërkombëtare për import

Neni 78

Nëse vërtetimi për përdorim përfundimtar, vërtetimi për përdorues përfundimtar dhe certifikatë ndërkombëtare për import të lëshuar nga ministri i Ekonomisë nuk janë dorëzuar në organin përkatës të huaj në afat prej gjashtë muajve nga miratimi i tyre ose malli përfundimtar nuk ka qenë i importuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dokumenti kthehet në ministri, së bashku me arsyetimin me shkrim më së voni në afat prej tre ditë pune nga skadimi i afatit prej gjashtë muajve nga lëshimi i tyre, përkatësisht pas marrjes së informatës se malli ushtarak nuk do të importohet në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Regjistri i vërtetimeve

Neni 79

Drejtoria mban regjistër të vërtetimeve për përdorim përfundimtar, regjistër për vërtetim të përdoruesit përfundimtar, regjistër të vërtetimit për dërgesa të kryera dhe regjistrim të vërtetimit për certifikatë ndërkombëtare për import, të parapara me këtë ligj që i evidenton të gjitha kërkesat e miratuara dhe të refuzuara për marrjen e vërtetimeve në pajtim me këtë ligj, si dhe ndryshime të vërtetimet e dhëna.

Ministri i Ekonomisë e përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së regjistrave sipas paragrafit (1) të këtij neni.

VII. LËSHIMI I CERTIFIKATËS PËR PERSONIN JURIDIK PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË HARMONIZIMIT TË BRENDSHËM

Personi juridik me certifikatë

Neni 80

Me lëshimin e certifikatës për zbatimin e programit për harmonizim të brendshëm (në tekstin e mëtejshëm: PHB) konfirmohet që personi juridik është sekret, në veçanti lidhur me përqëndrimin e personit juridik ndaj dispozitave të këtij ligji dhe respektimin e obligimeve dhe përkufizimeve lidhur me qarkullimin e mallrave ushtarake.

Certifikata lëshohet me kërkesë me shkrim të personit juridik.

Besueshmërinë e personit juridik e vlerëson drejtoria, me qëllim të marrjes së vërtetimit për harmonizimin e tij me kriteret për certifikim të përcaktuara me nenin 82 paragrafi 1 të këtij ligji.

Ministri i Ekonomisë e përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesës, mënyrën e certifikimit dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës për zbatim të PHB-së.

Programi për harmonizim të brendshëm

Neni 81

Qëllimi i PHB-së është vendosja e efekteve, masve përkatëse dhe propocionale dhe procedurave të cilat do t'u ndihmojnë personave juridikë:

- të sigurojnë masa mbrojtëse për harmonizim, duke përfshirë edhe ballafaqimin dhe përqëndrimin e politikave dhe procedurave standarde operative në të gjitha nivelet nga sinxhiri i furinizimeve të personit, që të sigurohet miratimi i vendimit unik në pikëpamjen e lëndëve të mallrave ushtarake në pajtim me dispozitat e këtij ligji, si dhe përpunimi i besueshëm i porosive dhe anaiza e thellë themelore,

- të shërbejë si mjet për ballafaqim të faktorëve/indikatoreve të rrezikuar me të cilat do të hapen çështjet rreth legjitimitetit të klientit ose të transaksionit,

- të mbrohen të punësuarit nga shkelja pa qëllim të dispozitave të këtij ligji nëpërmjet programit për trajnim dhe vetëdije publike.

Struktura bazë e PHB-së duhet të themelohet në elementet si vijojnë:

1. Kontributi i udhëheqësisë për harmonizim;
2. Struktura organozative dhe përkufizimi i obligimeve;
3. Procese dhe procedura për kontrollin e transaksioneve;
4. Kontrolli i dërgesave;
5. Revizioni i kontrollit të brendshëm;
6. Trajnime dhe edukim;
7. Menaxhimi i evidencës dhe ruajtja e dokumenteve;
8. Paraqitja dhe zbatimi i masave korigjuese;
9. Teknika dhe siguria informatike.

Ministria mund të kërkojë nga ofruesi i shërbimeve dhe i personave të cilët rregullisht kryejnë bartje elektronike të softuerit kontrollues ose teknologjisë, detyrimisht të vendosin PHB.

Ministri i Ekonomisë e përcakton përmbajtjen e PHB-së.

Kriteret për kontrollin e besueshmërisë

Neni 82

Besueshmëria e personit juridik sipas nenit 80 paragrafi (3) të këtij ligji, vlerësohet në pajtim me kriteret dhe dokumentet:

1. Numri i të punësuarve të kërkuarve, vëllimi i qarkullimit, natyra e transaksioneve, ndjeshmëria e mallrave me të cilat kryhet qarkullimi, profili i pranuesve, deklarata për përdorim përfundimtar të mallrave ushtarake dhe të shërbimeve të ndërlidhura;

2. Përvojë e dëshmuar në kryerjen e qarkullimit të mallrave ushtarake, në veçanti duke pasur parasysh sjelljen e personit juridik lidhur me përqëndrimin në përkufizimet eksportuese, aktvendimet e plotëfuqishme gjyqësore lidhur me atë çështje, harmonizimin për kryerjen e prodhimit ose qarkullimit të mallrave ushtarake dhe punësimin e kuadrit udhëheqës me përvojë;

3. Aktiviteti prodhues relevant me mallra ushtarake, në veçanti aftësia për integrim të sistemeve ose nënsistemeve;

4. Emërimi i personit udhëheqës i cili do të jetë përgjegjës për masat e kontrollit të qarkullimit të mallrave ushtarake;

5. Deklaratë me shkrim nga personi juridik, e nënshkruar nga personi përgjegjës sipas pikës 4 të këtij neni, me të cilën deklarohet se personi juridik do t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për përqëndrim dhe zbatim të të gjitha kushteve specifike në pikëpamjen e përforcimit të brendshëm, zbatimit të kontrollit të përdorimit përfundimtar të të gjitha mallrave ushtarake të cilat janë eksportuar, importuar ose tranzituar, si dhe sigurimin e kushteve;

6. Deklaratë me shkrim nga personi juridik, e nënshkruar nga personi përgjegjës sipas pikës 4 të këtij neni, në të cilën deklarohet se në Drejtori në kohë do të dorëzohen të dhënat si përgjigje e kërkesës për dorëzimin e informacioneve ose shpalljen e përdoruesve përfundimtarë ose përforcimi përfundimtar për të gjitha mallrat ushtarake të eksportuara, të bartura ose pranuar;

7. Përshkrimi i PHB-së zbatohet nga personi juridik, i nënshkruar nga personi përgjegjës. Përshkrimi përmban veçori për resurset organizative, njerëzore dhe teknike të cilat janë ndarë për udhëheqjen e qarkullimit të mallrave ushtarake, hierarkinë e përgjegjësisë në kuadër të ndërmarrjes, procedurën për kontrollin e transaksioneve në kuadër të revizionit të brendshëm, informimin për ngritjen e vetëdijes dhe trajnimin e të punësuarve, mekanizmat e sigurisë fizike dhe teknike, udhëheqjen e evidencës dhe përcjelljen e të gjitha veprimeve në pikëpamjen e mallrave ushtarake dhe harmonizimin e PHB-së që e zbaton kërkuar në pajtim me drejtimitet e përcaktuara në ministri.

Përmbajtja e certifikatës për PHB

Neni 83

Certifikata për PHB mund të përmbajë kushte plotësuese në pikëpamje të informacioneve të cilat janë të nevojshme për shkak të kontrollit të harmonizimit me kriteret e këtij ligji, si dhe kushtet për marrjen e përkohshme ose të përhershme të certifikatës.

Afati i vlefshmërisë dhe vazhdimi i certifikatës për PHB

Neni 84

Afati i vlefshmërisë së certifikatës PHB është deri pesë vjet.

Afati i vlefshmërisë së certifikatës vazhdohet në bazë të kërkesës me shkrim nga pronari, i parashtruar për Ministrinë më së voni gjashtëdhjetë ditë para kalimit të vlefshmërisë së certifikatës PHB.

Revizioni dhe mbikëqyrja e PHB-së

Neni 85

Gjatë vazhimit të vlefshmërisë së certifikatës PHB, personat e autorizuar (inspektorët) të drejtorisë mund të bëjnë revizion të PHB-së të personit juridik.

Heqja e certifikatës

Neni 86

Nëse revizioni përcakton se PHB nuk i përmbush kriteret e caktuara në nenin 82 të këtij ligji ose drejtimet e përcaktuara nga drejtoria, atëherë drejtoria nëpërmjet mbikëqyrjes inspektuese ndërmerri masa adekuate. Masat e tilla mund të përfshijnë marrje të përkohshme ose të përhershme të lejes globale përkatësisht shfrytëzimin e lejeve të përgjithshme.

Shpallja e listës me persona juridikë të certifikuar

Neni 87

Ministria në ueb faqen e vet shpall listë me persona të certifikuar juridikë për PHB.

VIII. OBLIGIMET E PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË ZHVILLIM, PRODHIM DHE NË QARKULLIM TË MALLRAVE USHTARAKE

Obligime

Neni 88

Çdo person i përfshirë në zhvillim, prodhim dhe qarkullim të mallrave ushtarake është i detyruar:

1. T'i respektojë kushtet për kryerjen e veprimtarisë, si dhe pa prolongim ta njoftoj Ministrinë për çdo ndryshim në leje;
2. Ta njoftojë Ministrinë në formë me shkrim për çdo ndryshim në lidhje me përdoruesin e fundit ose në lidhje me palën tjetër në eksportin, importin dhe tranzitin ose sigurimin e shërbimeve, në afat prej dhjetë ditëve nga ndryshimet e bëra;
3. Të mbajë evidencë në pajtim me dispozitat e përcaktuara në këtë ligj;

4. Ta njoftojë ministrinë në formë me shkrim ose elektronike për eksportin, importin dhe tranzitin e bërë, në afat prej shtatë ditëve nga mbarimi dhe pastaj të bashkëngjijtë kopje nga deklarata doganore;

5. Me kërkesë të ministrisë, të dorëzojë vërtetim për dërgesën dhe pranimin e mallit;

6. T'i kthejë lejen dhe certifikatën që nuk janë të shfrytëzuara në ministri në afat prej shtatë ditëve nga skadimi i periudhës së vlefshmërisë së lejes ose certifikatës;

7. Të shënojë në dokumente adekuate komerciale të cilët i përkasin vendosjes vendore në mallrave ushtarake të prodhuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, se bëhet fjalë për mallra të cilat i nënshtrohen kontroleve nëse eksportet jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut (dokumentet adekuate komerciale posaçërisht përfshijnë: marrëveshje për shitje, vërtetim të porosisë, faturës ose fletëdërgesës);

8. Ta informojë Ministrinë nëse merr njohuri se malli plotësisht ose pjesërisht do të dedikohet për zhvillim, prodhim, përdorim, mirëmbajtje, ruajtje, detektim, identifikim ose zgjerim të armëve për shkatërrim në masë, mjete për dërgesë të tij për qëllime ushtarake në destinacione të cilat janë nën embargo ose për rrezikimin e sigurisë nacionale;

9. Ta lejojë organin kompetent të inspektimit, të inspektojë mbikëqyrje inspektuese në evidencën për aktivitetet për zhvillim, prodhim ose qarkullim, si dhe të hyjë në ambiente për efekt të kontrollit të prodhimit, deponimit dhe mjeteve të transportit;

10. T'i respektojë detyrimet dhe kushtet e tjera të përfshira nga lejet ose certifikatat e lëshuara nga ministri i Ekonomisë, përkatësisht ministria në bazë të këtij ligji dhe

11. Ta informojë Ministrinë në formë të shkruar ose elektronike deri në fund të janarit të vitit vijues për qarkullimin e bërë të mallrave ushtarake nga viti paraprak.

Mbajtja e evidencës

Neni 89

Të gjithë personat e përfshirë në zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e mallrave ushtarake janë të detyruar të mbajnë në selinë e tyre regjistrat e çdo transaksioni, si dhe librat kryesor, biznesin dhe sistemet kompjuterike dhe të gjitha të dhënat tregtare dhe teknike dhe dokumentacionin në lidhje me zhvillimin, prodhimin dhe furnizimin e mallrave ushtarake, përfshirë kontratat, faturat, dërgesat, marrësit, dërgesat për të gjitha llojet e transportit dhe çdo dokumentacion tjetër në lidhje me mallrat ushtarake, (si dhe normat që përmbajnë të dhëna për sasinë e mallrave të nevojshme për prodhimin e secilit produkt në një njësi matëse).

Dokumentet sipas paragrafit (1) të këtij neni, përmbajnë veçanërisht të dhënat e mëposhtme:

- përshkrimi teknik i mallrave ushtarake që do të mundësojë klasifikimin e mallrave nga Lista nacionale e kontrollit ushtarak;

- përshkrimi i mallrave ushtarake që mundëson identifikimin e tyre, si dhe një shenjë tarifore në pajtim me Listën nacionale të kontrollit ushtarak;

- përshkrimin e shërbimeve;

- sasinë në njësi matëse dhe peshën neto dhe vlerën e mallrave ushtarake ose vlerën e shërbimeve të ofruara;

- emrin dhe selin e palëve në transaksion ose veprim;

- emrin e plotë dhe selinë, si dhe të dhënat nga regjistri përkatës, për eksportuesin, importuesin, personin përgjegjës për tranzitin ose ofruesin përkatës të shërbimit;

- emrin e plotë dhe selinë, si dhe të dhënat nga regjistri përkatës, për përdoruesin e fundit të mallrave ushtarake ose marrësin e shërbimit të mallrave ushtarake;

- korrespondencën e biznesit, postat elektronike dhe regjistrimet audio dhe video në lidhje me eksportin, importin dhe tranzitin e mallrave ushtarake, ose ofrimin e shërbimeve për mallrat ushtarake;

- porositë, faturat, kontratat, fletëporositë, dërgesat, listat e ngarkesave/udhëtarëve dhe dokumentacion tjetër në lidhje me eksportin, importin dhe tranzitin ose sigurimin e shërbimeve të mallrave ushtarake;

- datën e transaksionit ose të veprimit dhe
- dokumentacion tjetër.

Të gjithë personat e përfshirë në zhvillimin, prodhimin dhe qarkullimin e mallrave ushtarake janë të detyruar t'i sigurojnë dokumentacionin e përmendur në paragrafin (1) të këtij neni, përfaqësuesit të ministrisë ose një organi tjetër mbikëqyrës me kërkesë të ministrisë ose me kërkesë të një organi tjetër mbikëqyrës.

Evidenca, përkatësisht të dhënat dhe dokumentet nga ky nen, personat janë të detyruar t'i mbajnë për një periudhë dhjetë vjeçare nga fundi i vitit kalendarik, në të cilin është kryer çdo transaksion individual, përkatësisht shërbimi i mallrave ushtarake.

Neni 90

Eksportuesi i cili kryen eksport të mallrave ushtarake është i obliguar:

- të mbajë evidencë të posaçme për eksportin e kryer të mallrave ushtarake;
- ta ushtrojë veprimtarinë në pajtim me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në lejen për eksport dhe
- për çdo ndryshim të kushteve të ushtrimit të eksportit të mallrave ushtarake menjëherë në formë me shkrim ta njoftojë Ministrinë.

Eksportuesi nuk guxon t'ia bartë lejen për eksport personit tjetër.

Neni 91

Brokleri i cili kryen shërbime brokere të mallrave ushtarake është i obliguar:

- të mbajë evidencë të posaçme për shërbimet e kryera brokere për mallra ushtarake,
- ta ushtrojë veprimtarinë në pajtim me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në lejen për shërbime brokere dhe
- për çdo ndryshim të kushteve të ushtrimit të shërbimeve brokere për mallra ushtarake menjëherë në formë me shkrim ta njoftojë Ministrinë.

IX. MBROJTJE DHE SIGURI NË ZHVILLIMIN, PRODHIMIN DHE QARKULLIMIN E MALLRAVE USHTARAKE

Masa dhe procedura për mbrojtje dhe siguri

Neni 92

Mbrojtja dhe siguria e zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit i mallrave ushtarake përfshin:

- masa dhe procedura për sigurimin e mbrojtjes së kapaciteteve për zhvillimin dhe prodhimin e mallrave ushtarake për vendosje dhe ruajtje të atyre mallrave,
- masa për sigurim gjatë transportit të mallrave ushtarake dhe
- ruajtje dhe mbrojtje të informacioneve të klasifikuara për kapacitete për zhvillim, prodhim, qarkullim, objektet për vendosje dhe ruajtje të mallrave ushtarake, si dhe masa tjera të përcaktuara për mbrojtje dhe siguri.

Neni 93

Kryerësit e zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake janë të obliguar të organizojnë dhe t'i zbatojnë masat për mbrojtje dhe siguri në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji, si dhe në pajtim me rregullat tjera me të cilat rregullohet mbrojtja dhe ruajtja e të dhënave të klasifikuara të mbrojtjes dhe të sigurisë dhe veprimit me eksploziv, lëndë ndezëse dhe materie tjera të rrezikshme.

Neni 94

Për shkak të mbrojtjes dhe sigurimit të objekteve, kapaciteteve, repromaterialeve dhe prodhimeve të gatshme, prodhuesit të mallrave ushtarake janë të obliguar të angazhojnë ose formojnë shërbim dhe njësi për sigurim.

Neni 95

Në rajonet të objekteve në të cilat ushtrohet prodhim, vendosje dhe ruajtje të mallrave ushtarake nuk mund të ndërtohen objekte të tjera pa pajtim të Qeverisë.

Në rajonet e objekteve sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të ndalohet lëvizja nëse ekziston rrezik nga kërcënimi i sigurisë së qytetarëve ose të atyre objekteve.

Rajonet e objekteve sipas paragrafit (1) të këtij neni i cakton Qeveria me vendim.

Plane për sigurim teknik dhe fizik dhe mbrojtje nga zjarri

Neni 96

Prodhuesit e mallrave ushtarake miratojnë plane për sigurim teknik dhe fizik dhe mbrojtje nga zjarri të kapaciteteve për prodhim dhe të objekteve për vendosje dhe ruajtje të mallrave ushtarake dhe plane të tjera për zbatimin e masave për mbrojtje të sigurisë, si dhe udhëzime më të afërta për zbatimin e atyre masave, në pajtim me rregullat me të cilat rregullohen këto çështje.

Neni 97

Të dhënat për kapacitete për prodhim të mallrave ushtarake, programet, planet për zhvillim, për import dhe eksport të mallrave ushtarake, për bashkëpunim shkencor teknik me jashtë në sferën e prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake, konsiderohen si informacione të klasifikuara nga sfera e mbrojtjes dhe e sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 98

Municioni, eksplozivet dhe mallrat e tjera ushtarake të cilat paraqesin materie të rrezikshme, transportohen me automjete speciale ose standarde të transportit dhe me përcjellje në pajtim me rregullat për transport të materieve të rrezikshme.

Prodhuesit e mallrave ushtarake, kryerësit e qarkullimit të mallrave ushtarake, përkatësisht transportuesit e mallrave ushtarake, janë përgjegjës për sigurimin e mallrave ushtarake deri në dorëzimin të blerësi, përkatësisht përodruesi.

Mbajtja e evidencës

Neni 99

Prodhuesit e mallrave ushtarake dhe kryerësit e qarkullimit të mallrave ushtarake dhe subjektet e tjera të cilat ruajnë mallra ushtarake për nevojat e veta ose mbi të cilën bazë disponojnë me mallra ushtarake, janë të obliguar për mallrat ushtarake të mbajnë evidencë të posaçme.

Subjektet sipas paragrafit (1) të këtij neni janë të obliguar për çdo humbje të përcaktuar të mallrave ushtarake ose të pjesëve të tyre, menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej 24 orë ta njoftojnë Ministrinë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

X. MBIKËQYRJE

Organ i mbikëqyrjes

Neni 100

Mbikëqyrje në zbatimin e dispozitave të këtij ligji ushtron Ministria nëpërmjet inspektorëve të Drejtorisë, për kryerjen e detyrave dhe të punës së mbikëqyrjes inspektuese.

Drejtoria nëpërmjet inspektorëve ushtron kontroll të harmonizimit me kushtet nga certifikata për PHB më së paku një herë në çdo tre vjet.

Drejtoria nëpërmjet inspektorëve ushtron kontroll më së paku një herë në vit te subjektet juridike në lidhje me plotësimin e kushteve nën të cilat janë miratuar aktvendime për pajtim, për zhvillim ose prodhim dhe leje për qarkullim të mallrave ushtarake.

Drejtori i Drejtorisë miraton program vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese dhe përpilon plane mujore për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese.

Drejtori i Drejtorisë dorëzon raport vjetor te Ministria për mbikëqyrjen e realizuar inspektuese në vitin paraprak, më së voni deri në 31 mars të vitit vijues.

Neni 101

Inspektori i Drejtorisë për Kryerjen e Detyrave dhe Punëve të Mbikëqyrjes Inspektuese, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, mund të jetë personi i cili:

- i plotëson kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin e Nëpunësve Administrativë;
- ka fituar më së paku 240 kredite sipas SETK-së, ose ka diplomë universitare, në një nga fakultetet në vijim: fakulteti i filozofisë - drejtimi: mbrojtje, fakulteti i sigurisë ose fakulteti i teknikës dhe
- ka së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

Neni 102

Inspektori i Drejtorisë për Kryerjen e Detyrave dhe Punëve të Mbikëqyrjes Inspektuese, në pajtim me këtë ligj, kanë legjitimacion me të cilin përcaktohet cilësia e tyre zyrtare të cilën janë të obliguar ta tregojnë kur i zbatojnë autorizimet e këtij ligji.

Ministri i Ekonomisë e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimacionit, si dhe mënyrën e dhënies dhe marrjes së legjitimacionit.

Legjitimacionin e jep ministri i Ekonomisë.

Neni 103

Mbikëqyrjen në zbatimin e masave për mbrojtje dhe siguri në zhvillimin, prodhimin dhe qarkullimin e mallrave ushtarake, e ushtrojnë inspektorët të Drejtorisë për Kryerjen e Detyrave dhe Punëve të Mbikëqyrjes Inspektuese, në pajtim me këtë ligj.

Masa për zbatimin e mbikëqyrjes

Neni 104

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektorët janë të autorizuar:

- të kërkojnë informacione dhe të dhëna të nevojshme për kryerjen e kontrollit nga cilido person në aktivitete me zhvillimin, prodhimin dhe qarkullimin e mallrave ushtarake;
- të kërkojnë mendim nga organe dhe institucione tjera adekuate;
- të ushtrojnë kontroll të çdo transaksioni individual, përkatësisht rol për mallra ushtarake, si dhe kontroll të të dhënave për mallra ushtarake me të dhënat nga loja e dhënë;
- të ushtrojnë kontroll në hapësirat afariste, kapacitetet prodhuese dhe hapësirat e magazinimit të personave të cilët kanë marrë pajtim për ushtrim të zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake.

Drejtoria, mund sipas nevojës të dorëzojë kërkesë te institucionet kompetente përkatëse për sigurimin e informacioneve të nevojshme për mbikëqyrje.

Neni 105

Nëse inspektori gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese përcakton parregullsi, do të miratojë aktvendim për ndalesë të përkohshme për ushtrim të veprimtarisë në kohëzgjatje prej tridhjetë ditësh, përkohësisht do t'i konfiskojë lëndët në lidhje me të cilat është bërë shkelja dhe do të caktojë afat prej pesëmbëdhjetë ditë të mënjanohen parregullsitë të përcaktuara me konstatimin.

Sendet e marra sipas paragrafit (1) të këtij neni do të magazinohen në magazina adekuata të Ministrisë së Mbrojtjes, përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme deri në përfundimin e procedurës.

Për marrjen e bërë të sendeve sipas paragrafit (1) të këtij neni, inspektori jep vërtetim.

Kundër aktvendimit sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të deklarohet ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendimmarje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Ankesa e deklaruar kundër aktvendimit sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk e prolongon zbatimin e saj.

Në procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në mënyrë adekuata do të zbatohen dispozitat e Ligjit të Mbikëqyrjes Inspektuese, nëse me këtë ligj më ndryshe nuk është rregulluar.

Neni 106

Nëse gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese në pajtim me këtë ligj haset në dëshmi për vepra të mundshme penale të lidhura me inkriminim në lidhje me importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave ushtarake në atë rast, informacionet ose dëshmitë e mundshme inspektori do t'i kërkojë nga Drejtoria e Doganave.

Neni 107

Për mbikëqyrjen e kryer inspektuese përpilohet procesverbal në të cilin futet konstatimi për gjendjen e përcaktuar faktike.

Procesverbalin e nënshkruajnë personat të cilët marrin pjesë në procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

XI. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Sanksione kundërvajtëse

Neni 108

Gjobë në shumë prej 4.000 deri në 8.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik prodhues, përkatësisht kryerës i qarkullimit të mallrave ushtarake, nëse:

1. bën zhvillim, prodhim ose qarkullim të mallrave ushtarake pa pajtim të marrë për kryerjen e veprimtarisë adekuata, në pajtim me nenin 6 të këtij ligji;

2. nëse pas marrjes së pajtimit nga neni 6 të këtij ligji, nuk i plotëson kushtet në bazë të të cilës është lëshuar;

3. nëse kryerësi i zhvillimit, prodhuesi ose kryerësi i qarkullimit nuk i plotëson detyrimet nga neni 88 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 2.000 deri në 4.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personit juridik për kundërvajtje të kryer sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Krahas gjobës sipas paragrafit (1) të këtij neni, personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e veprimtarisë prodhim dhe qarkullim të mallrave ushtarake në kohëzgjatje prej një deri në pesë vjet.

Krahas gjobës sipas paragrafit (1) të këtij neni, personit përgjegjës të personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje prej një deri në pesë vjet.

Në rastet sipas paragrafit (1) pika 1 dhe 2 të këtij neni do t'i shqiptohet masë e veçantë kundërvajtëse konfiskim i sendeve me të cilat është kryer kundërvajtja.

Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen para se të parashtrijë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente, inspektori është i obliguar t'i propozojë kryerësit të procedurës së kundërvajtjes procedurë për barazim.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit (person fizik) për kundërvajtjet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 109

Gjobë në shume prej 2.000 deri në 4.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik prodhues të mallrave ushtarake, nëse:

1. nuk siguron cilësi në prodhimin e mallrave ushtarake në pajtim me standardet maqedonase, përkatësisht sipas standardeve adekuate ndërkombëtare dhe të NATO-së të cilit janë pranuar në Republikë në pajtim me nenin 41 të këtij ligji;

2. nuk siguron kontroll të cilësisë, siguri të mallrave ushtarake gjatë importit të mallrave ushtarake në pajtim me nenin 42 të këtij ligji;

3. nuk organizon dhe nuk i zbaton masat për mbrojtje dhe siguri të prodhimit të mallrave ushtarake në pajtim me këtë ligj dhe rregullat të miratuara në bazë të këtij ligji, si dhe rregullat tjera me të cilat rregullohet mbrojtja dhe ruajtja e të dhënave sekrete të mbrojtjes dhe sigurisë dhe veprimi me eksplozive, materie ndezëse dhe materie tjera të rrezikshme në pajtim me nenin 93 dhe 94 të këtij ligji;

4. nuk angazhojnë ose formojnë shërbime dhe njësi për sigurim në pajtim me nenin 94 të këtij ligji;

5. ndërton objekte në rajonet të objekteve në të cilat bëhet prodhim, vendosje dhe ruajtje e mallrave ushtarake pa pajtim të Qeverisë në pajtim me nenin 95 të këtij ligji;

6. nuk miraton plane për sigurim teknik dhe fizik dhe mbrojtje nga zjarret të kapaciteteve për prodhim dhe të objekteve për vendosje dhe ruajtje të mallrave ushtarake dhe plane të tjera për zbatimin e masave për mbrojtje dhe siguri në pajtim me nenin 96 të këtij ligji;

7. nuk u përmbahet rregullave për masat dhe mënyrën e sigurimit të transportimit të mallrave ushtarake në pajtim me nenin 98 të këtij ligji dhe

8. nuk mban evidencë të posaçme për mallra ushtarake me të cilat disponon në pajtim me nenin 99, paragrafi (1) të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje të kryer sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Krahas gjobës sipas paragrafit (1) të këtij neni personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e veprimtarisë, prodhim të mallrave ushtarake në kohëzgjatje prej një deri në pesë vjet.

Krahas gjobës sipas paragrafit (1) të këtij neni personit përgjegjës të personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje prej një deri në pesë vjet.

Për kundërvajtjet e përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, para se të parashtrijë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente, inspektori është i obliguar t'i propozojë kryerësit të procedurës së kundërvajtjes procedurë për barazim.

Neni 110

Gjobë në shume prej 2.000 deri në 4.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik prodhues të mallrave ushtarake, nëse:

1. lëshon në qarkullim mallra ushtarake pa u përmbushur kushtet e këtij ligji në pajtim me nenin 6 paragrafi (3) dhe neni 50 paragrafi (1) të këtij ligji;

2. kryen import të mallrave ushtarake pa kryer paraprakisht kontroll të cilësisë së mallrave ushtarake në pajtim me nenin 53 të këtij ligji;

3. nuk i njofton Ministrinë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme për humbjen e mallrave ushtarake ose të pjesëve të tyre menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej 24 orësh, në pajtim me nenin 99 paragrafi (2) të këtij ligji.

Gjobë në shume prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje të kryer sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Krahas gjobës sipas paragrafit (1) të këtij neni personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e veprimtarisë prodhim të mallrave ushtarake në kohëzgjatje prej një deri në pesë vjet.

Krahas gjobës sipas paragrafit (1) të këtij neni personit përgjegjës të personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje prej një deri në pesë vjet.

Për kundërvajtjet e përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, para se të parashtrojë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse para gjykate kompetente, inspektori është i obliguar t'i propozojë kryerësit të procedurës së kundërvajtjes procedurë për barazim.

Neni 111

Gjobë në shumë prej 4.000 deri në 8.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik prodhues, përkatësisht ushtrues i qarkullimit me mallra ushtarake, nëse pa pajtim mundëson investimin e mjeteve të personave të huaj në shoqëri tregtare që zhvillon ose prodhon mallra ushtarake në pajtim me nenin 7 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje të kryer sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Krahas gjobës sipas paragrafit (1) të këtij neni personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e veprimtarisë prodhim dhe qarkullim të mallrave ushtarake në kohëzgjatje prej një deri në pesë vjet.

Krahas gjobës sipas paragrafit (2) të këtij neni personit përgjegjës në personin juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje prej një deri në pesë vjet.

Në rastet sipas paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet mase e veçantë kundërvajtëse konfiskim i sendeve me të cila është kryer kundërvajtja.

Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, para se të parashtrojë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente, inspektori është i obliguar t'i propozojë kryerësit të kundërvajtjes procedurë për sheshim.

Neni 112

Gjobë në shumë prej 2.000 deri në 4.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje kryerësit të zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake, nëse nuk dorëzon te Ministria ekzemplar nga çdo aktvendim për regjistrimin e qarkullimit në Regjistrin Qendror në pajtim me nenin 25 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje të kryer sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Krahas gjobës sipas paragrafit (1) të këtij neni, personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e veprimtarisë prodhim dhe qarkullim të mallrave ushtarake në kohëzgjatje prej një deri në pesë vjet.

Krahas gjobës sipas paragrafit (2) të këtij neni personit përgjegjës në personin juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje prej një deri në pesë vjet.

Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, para se të parashtrojë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente, inspektori është i obliguar t'i propozojë kryerësit të kundërvajtjes procedurë për barazim.

Neni 113

Gjobë në shumë prej 2.000 deri në 4.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit juridik kryerës i zhvillimit, prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake, për kundërvajtje të kryer sipas neni 109, paragrafi (1) të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje të kryer sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Krahas gjobës sipas paragrafit (1) të këtij neni personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e veprimtarisë prodhim dhe qarkullim të mallrave ushtarake në kohëzgjatje prej një deri në pesë vjet.

Krahas gjobës sipas paragrafit (2) të këtij neni personit përgjegjës në personin juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje prej një deri në pesë vjet.

Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, para se të parashtrojë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente, inspektori është i obliguar t'i propozojë kryerësit të kundërvajtjes procedurë për barazim.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit (person fizik) për kundërvajtjet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

XII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 114

Personat të cilët kryejnë zhvillim, prodhim dhe qarkullim të mallrave ushtarake janë të obliguar në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji ta harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij ligji.

Neni 115

Personat të cilët kanë marrë pajtim për kryerjen e prodhimit dhe qarkullimit të armatimit dhe pajisjes ushtarake në pajtim me Ligjin e Prodhimit dhe të Qarkullimit të Armatimit dhe të Pajisjes Ushtarake ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 54/2002, 84/2007, 161/2009, 145/10, 119/13, 164/13 dhe 41/14, 192/15, 39/16 dhe 64/18), deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë të obliguar të dorëzojnë kërkesë të re me dokumente të dorëzuara në pajtim me këtë ligj në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Personat të cilët nuk do të veprojnë në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, do të konsiderohet se nuk posedojnë pajtim që të kryejnë prodhim dhe qarkullim të mallrave ushtarake.

Neni 116

Lejet e dhëna për qarkullim të armatimit dhe të pajisjes ushtarake, në pajtim me Ligjin e Prodhimit dhe të Qarkullimit të Armatimit dhe të Pajisjes Ushtarake ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 54/2002, 84/2007, 161/2009, 145/10, 119/13, 164/13 и 41/14, 192/15, 39/16 dhe 64/18) vazhdojnë të vlejnë deri në përfundimin e afatit të kalimit të tyre.

Neni 117

Procedurat për marrje të pajtimit për kryerjen e prodhimit dhe qarkullimit të mallrave ushtarake dhe për marrjen e lejes për kryerje dhe qarkullim të mallrave ushtarake të cilat kanë filluar me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit ekzistues të Prodhimit dhe të Qarkullimit të Armatimit dhe të Pajisjes Ushtarake (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 54/2002, 84/2007, 161/2009, 145/10, 119/13, 164/13 dhe 41/14, 192/15, 39/16 dhe 64/18).

Neni 118

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 12 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në miratimin e akteve sipas paragrafit (1) të këtij neni, do të zbatohen aktet nënligjore të cilat janë miratuar në bazë të ligjeve të cilat kanë qenë në vlefshmëri deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 119

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji i Prodhimit dhe i Qarkullimit të Armatimit dhe të Pajisjes Ushtarake (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 54/2002, 84/2007, 161/2009, 145/10, 119/13, 164/13, 41/14, 192/15, 39/16 dhe 64/18).

Neni 120

Dispozitat e nenit 51, paragrafi (8) të këtij ligji që ka të bëjë me dhënien e lejes globale dhe do të fillojnë të zbatohen ditën e aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashikimin European.

Neni 121

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.